



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Administrim Biznesi”
Universiteti “Epoka”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof.Dr. Raimonda DUKA
Prof.Asoc.Dr Etleva LESKAJ**

Shtator / 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bsc në "Administrim Biznesi"

1	IAL aplikues:	Universiteti "Epoka"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim-Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Administrim Biznesi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 281, datë 12.03.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 565, datë 22.11.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 96, datë 20.10.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	22 PAE / 11 PAK
18	Numri i studentëve:	134 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Epoka", është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 281, datë 12.03.2008. Universiteti "Epoka", zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Universiteti "EPOKA" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.92, date 20.10.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2021.

Universiteti "Epoka", është i organizuar në 3 fakultete, 2 Qendra kërkimore dhe 8 departamente. Fakultet në përbërje të Universiteti "Epoka", janë :

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë;
2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative;
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" licensuar me VKM Nr. 281, datë 12.03.2008. Vendimi i parë për riorganizimin, është VKA Nr. 313, datë 16.03.2012, miratuar me Urdhër Nr. 312 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës datë 27.07.2012, ku riorganizuan ciklin e parë të programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" nga katër (4) vite, që ishte kohëzgjatja normale e studimeve akademike (240 ECTS), në Bachelor në "Administrim Biznesi" me kohëzgjatje normale studimesh prej tre (3) vitesh akademike (180 ECTS).

Programi është akredituar për herë të parë, me UMASH Nr. 260, datë 07.06.2011 me afat deri në 07.06.2017. Akreditimi periodik i programit, është bërë me VBA Nr. 96, datë 20.10.2017. Kohëzgjatja e këtij akreditimi është 3 vite, me afat 30.09.2020.

Programi i studimit Bachelor në "Administrim Biznesi", ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSHEA).

FSHEA është i organizuar në tre departamente:

1. Departamenti i Financë – Bankës;
2. Departamenti i Administrim – Biznesit;
3. Departamenti i Ekonomiksit;

Departamenti i Administrim Biznesi, ofron studime në shtatë programe, tre të ciklit të parë bachelor dhe tre të ciklit të dytë dhe një program studimi të ciklit të tretë si më poshtë:

1. Bachelor në Administrim Biznesi;
2. Bachelor në Informatikë Ekonomike;
3. Bachelor në Marketing ndërkombëtar dhe menaxhim logjistike;
4. Master Profesional Administrim Biznesi;
5. Master Profesional Menaxhim Biznesi, me profil menaxhim arsimi;

6. Master i Shkencave në Administrim Biznesi;
7. Doktoratë në Administrim Biznesi;

Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi, pranë Universitetit Epoka, është hartuar për të përgatitur administratorë të aftë për t'i shërbyer administrimit të suksesshëm të organizatave private dhe publike. Duke iu referuar webit të institucionit dhe të departamentit, misioni i Departamentit të Administrim Biznesit është "edukimi i profesionistëve të rinj për krijimin e vlerës midis aktorëve të tregut.etj". Programi është i strukturuar në tre vite akademike dhe 6 semestra dhe në kurrikulën e tij ka, një diversitet lëndësh të formimit të përgjithshëm, formimit bazë, karakterizues si dhe lëndë me zgjedhje, për t'i mundësuar administratorëve të ardhshëm të biznesit që të përmbushin sfidat e mjedisit dinamik global.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 96, datë 20.10.2017 janë:

1. Të përfshihet në kurrikulën e këtij programi studimi praktika profesionale si veprimtari e detyrueshme;
2. Të rritet numri i teksteve në bibliotekë në funksion të realizimit të këtij programi studimi;
3. Në kuadër të rekrutimit të stafit të ri akademik, Institucioni duhet të parashikoj kritere për përfshirjen edhe të stafit vendas me njohje në terminologjinë e fushës së këtij programi studimi si dhe në fushën e zhvillimit social, ekonomik e politik të vendit për të mbuluar hapsirën që nuk mund të mbulohet nga stafi akademik i huaj;
4. Institucioni të shikojë mundësinë e mbështetjes së programit të studimit nga burime të tjera financiare, përveç të ardhurave nga tarifat e studimit;
5. Të mundësohen kurse afatshkurtra të gjuhës angleze teknike të fushës për të lehtësuar marrjen e dijeve nga studentët në kuadër të këtij programi që zhvillohet në gjuhën angleze.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. GVJ duke iu referuar dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit, konstaton se institucioni, me vendim të Senatit Akademik, ka përfshirë praktikën profesionale, në planin mësimor të vitit akademik 2020-2021. [Professional Practice Proposal_2020-2021]. GVJ konstaton se praktika profesionale do të zhvillohet në semestrin e 5-të. Ngarkesa javore e saj do të jetë 7 orë. Ajo është ideuar të ketë 1 orë teori dhe 6 orë praktikë. Praktika do të vlerësohet me 5 ECTS.

GVJ duke marrë në konsideratë se rekomandimi është lënë në përfundim të vitit akademik 2016-2017, institucioni duhet të kishte vlerësuar mundësinë e përfshirjes së

praktikës profesionale më herët, së paku për vitet akademik 2018-2019 dhe 2019-2020, duke iu krijuar mundësinë studentëve të regjistruar në këto viteve akademike, të kishin praktikën profesionale pjesë të kurrikulës së tyre të sudimit. **GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur kryesisht**

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit 1	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

2. GVJ mbështetur në dokumentacionin që përmban DVV dhe nga vizita në institucion, konstaton se biblioteka e institucionit është pasuruar me libra në mënyrë të vazhdueshme, mbi kërkesat e stafit akademik të departamentit dhe të fakultetit. Gjithashtu biblioteka e Universitetit Epoka, ka akses në shfrytëzimin e databazës elektronike të JSTOR, duke krijuar mundësi për stafin dhe studentët e programit për një gamë të gjerë dhe cilësore literature [45. List of Books BUS; 45.1 Library Annex (1) ; Request for books 2017-2018; Request for books 2018-2019]. **GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit 2.	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

3. GVJ referuar [RVBP_BA BUS_Tabelat permbledhese_shqip], konstaton se institucioni e ka marrë në konsideratë këtë rekomandim, duke rritur numrin e stafit vendas në program. Për vitin akademik 2019-2020, konstatohen se 6 nga 28 anëtarë të stafit akademik të përfshirë në program, janë të huaj, disa prej tyre me disa vite të eksperience në Universitetin Epoka dhe tashme të aklimatizuar me mjedisin social, ekonomik e politik të vendit. **GVJ është e mendimit se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit 3	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

4. GVJ konstaton se Institucioni ka ndërmarrë iniciativa të ndryshme, për mbështetjen e PS Bsc. në Administrim Biznesi, nga burime të diversifikuara financiare, përveç se nga të ardhurat nga tarifat e studimit. Në sajë të marrëveshjeve në kuadër të programit Erasmus+, mobilitetet e stafit akademik dhe studentëve financohen nga programi Erasmus+. Pavarësisht se institucioni nuk përfiton direkt fonde, por stafit akademik dhe studentëve, iu mbulohen shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimit, në përputhje të plotë me guidën e programit Erasmus+. Departamenti i Administrim Biznesit, nga ana tjetër, është ndër partnerët kryesorë të Qendrës “Yunus për Biznes Social dhe Qëndrueshmëri”. Nëpërmjet përfshirjes në projekte të trajnimit, konsulencave dhe studimeve që realizohen

nëpërmjet kësaj qendre, nga stafi akademik i Departamentit të Administrim Biznesit, ky department gjeneron fonde shtesë nga burime të diversifikuara. **GVJ është e mendimit se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit 4	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

5. Duke iu referuar planit mësimor të Bsc në Administrim iznesiB, GVJ konstaton se ky rekomandim është plotësuar nëpërmjet përfshirjes në planin mësimor, të dy lëndëve, Anglishte bazë dhe Zhvillimi i aftësive të të lexuarit dhe të shkruarit. **GVJ është e mendimit se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Shkalla e përmbushjes së rekomandimit 5	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” të ofruar nga Departamenti i Administrim Biznesit pranë Universitetit “Epoka”, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjegje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UE, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Raimonda Duka dhe Prof.Asoc. Etleva Leskaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Vizita 2 ditore në Universitetin “Epoka”, u realizua gjatë datave 11-12/06/2020, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL.

Gjatë ditëve të vizitës, në Universitetin “EPOKA”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësën e Departamentit të Administrim Biznesit dhe Dekanin e

FSHEA, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së planifikimit të karrierës dhe Studentëve të diplomuar, përfaqësues të Zyrës së Hulumtimit dhe projekteve si dhe me sekretarinë mësimore. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Universiteti Epoka është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.09.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 94/28 Prot, datë 04.09.2020. Universiteti Epoka përcjell në ASCAL më datë 16 shtator, me anë të shkresës me Nr. 105/24 Prot, datë 05.09.2020 “Komente në lidhje me draft raportin”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.4 Kriteri 5;

GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e mirë dhe duhet të vazhdojë, pasi mundëson jo vetëm pasurimin e fondeve por dhe përditësimin e literaturës.

Universiteti “EPOKA” përditëson dhe pasuron literaturën e programit të studimit “Bachelor” në “Administrim Biznes”, bazuar në kërkesat vjetore të Departamentit të Administrim Biznesit. Kjo përbën një strategji parësore të vënë në zbatim nga institucioni. Ndërkohë, pasurimi i literaturës se bibliotekës mundësohet edhe nëpërmjet donacioneve. Më poshtë gjendet linku i lajmit mbi dhurimin e rreth 300 titujve nga Universiteti i Tennessee në Chattanooga për Bibliotekën e Universitetit “EPOKA”.

<http://www.epoka.edu.al/news-the-university-of-tennessee-at-chattanooga-donates-around-300-books-to-epoka-university-s-library-5014.html>

Argumenti i GVJ: kriteri është vlerësuar pozitivisht nga ana e GVJ. Shtimi i fondeve përmes blerjeve është evidentuar si një praktikë e mirë dhe GVJ ka rekomanduar që duhet të vazhdojë. Komenti ka të bëjë me pasurimin e bibliotekës përmes donacioneve, i cili është evidentuar në raport por i pambështetur në evidencë. Evidenca që i vihet në dispozicion GVJ pas vizitës nuk merret në konsideratë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.5 Kriteri 4,


GVJ mendon që krahas këtyre raporteve NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar.

Referuar kriterit për standardin VI.5 në të cilin kërkohet që institucioni të vlerësojë dhe të sigurojë efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, si dhe referuar komentit të paraqitur në draft-RVJ që krahas këtyre raporteve, NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar, GVB gjykon se instrumentet vlerësuese të përcaktuara nga NJSBC janë të mjaftueshme dhe efektive për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Kështu, mekanizmat kryesorë të matjes të përcaktuara nga NJSBC në bazë të të cilave Universiteti “EPOKA” kryen vetëvlerësimin janë:

- Pyetësorët me studentët që plotësohen në fund të çdo semestri, ku studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe brendinë e lëndës. Në fund të çdo semestri, në bazë të rezultateve të pyetësorit, departamenti përkatës harton një raport ku përfshihen të dhëna sasiore, cilësore, analiza si dhe plan veprimi, të cilat përcillen për shqyrtim të mëtejshëm në mbledhjet e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC).
- Raporti i departamentit për rezultatet përfundimtare të studentëve për të gjitha lëndët. Në fund të çdo semestri, në bazë të rezultateve të studentëve, departamenti harton një raport ku përfshihen të dhëna sasiore dhe analiza të cilat përcillen për shqyrtim të mëtejshëm në mbledhjet e KPSC-së.
- Raporti Vjetor i Bordit të Provimeve mbi cilësinë e përmbajtjes së provimeve dhe korigjimeve. Raporti përmban të dhëna sasiore dhe cilësore mbi cilësinë e provimeve dhe përcillet për shqyrtim të mëtejshëm në mbledhjet e KPSC-së dhe i dërgohet njësive përkatëse për të adresuar problematika nëse ka.
- Raporti Vjetor i cili përfshin informacione dhe analiza mbi treguesit kryesor të performancës së programeve të studimit siç është niveli i diplomimit të studentëve, shkalla e kalimit të studentëve për të matur rezultatet e të nxënit dhe punësimin e studentëve të diplomuar. Koordinimi dhe mbledhja e të dhënave dhe raportimi kryhet nga Njësia e Mbledhjes dhe Analizës së të Dhënave, e cila përbëhet nga përfaqësues të të gjithë njësive kryesore dhe njësive të tjera dhe operon nën NJSBC.

Argumenti i GVJ: kriteri është vlerësuar pozitivisht nga ana e GVJ. Rekomandimi i dhënë nuk sugjeron shtimin e instrumentave të vlerësimit, pasi ato janë konsideruar në raport si të mjaftueshme dhe efektive. GVJ ka rekomanduar që NJSBC të hartojë një raport mbi aktivitetin e saj, në të cilin të analizohet aktiviteti i NJSBC dhe ndikimi që ka patur veprimtaria e saj në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

 8



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim Biznesi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Universiteti EPOKA synon arritjen e standardeve më të larta akademike, mbështetjen e aspiratave arsimore dhe arritjet e të gjithëve, promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor, përgatitjen e specialistëve të lartë duke ndihmuar zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Ndërsa PS ka për qëllim përgatitjen e administratorëve të aftë për t'i shërbyer administrimit të suksesshëm të organizatave private dhe publike.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që PS i ofruar nga IAL mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare.</p> <p>[Aneks:1.2_statute-of-epoka-university, neni 3; 1.3_BUS Department Strategic Plan 2017-2022, fq.1]</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>IAL ofron programe studimi në fushën e inxhinierisë, teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë, të cilat janë fusha të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë kombëtare dhe ku punësohen aktualisht më shumë se 50% e fuqisë punëtore. PS të ofruara përputhen gjithashtu me strategjinë e punësimit të qeverisë shqiptare në të cilën theksohet roli i arsimit në fushën e IT dhe biznesit. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstaton që IAL e mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në traditat më të mira kulturore, arsimore dhe shkencore të vendit të cilat janë evidentuar në planin strategjik të Departamentit të AB. [RVB, fq. 10; 1.3_BUS Department Strategic Plan 2017-2022, fq.1-2]</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>IAL synon të përgatisë individë të kualifikuar, të orientuar drejt hulumtimit shkencor, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare. Konkretizimi i misionit mbështet në arritjen e disa synime kryesore si: përgatitjen e specialistëve të lartë në përputhje me kërkesat dhe nevojat në ndryshim dhe zhvillimin e shoqërisë; ofrimin e studimeve të thelluara akademike dhe kryerjen e hulumtimeve në fusha të ndryshme; integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor; sigurimin e</p>

	<p>një kualifikimi të vazhdueshëm dhe bashkëkohor për stafin akademik; të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal; etj.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që programet e studimit janë hartuar dhe ofrohen në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit.</p> <p>[RVB, fq. 11; 1.3_BUS Department Strategic Plan 2017-2022]</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Universiteti EPOKA përfshin tre Njësi kryesore: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Qendra për Studime Evropiane.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që programet e studimit të hartuara nga Njësitë kryesore synojnë ".të kontribuojnë ndër të tjera në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale". IAL është përfshirë gjithashtu dhe në projekte ndërkombëtare, të cilat synojnë në konsolidimin e aftësive për të mbështetur sipërmarrjen dhe aktivitetet e reja.</p> <p>[Annex:1.2_statute-of-epoka-university, neni 3; 1.3_BUS Department Strategic Plan 2017-2022, fq.1; Aneks 1.11 EU4Innovation_ Capacity Building E+I Albanian Universities-findings]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi I.2</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional, si Strategjia dhe Plani veprimit i IAL 2018-2022; Plani Strategjik i Departamentit 2017-2022 dhe Statuti i IAL, GVJ konstatoi që PS Bachelor në "Administrim Biznes" është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit. Qëllimi dhe objektivat e PS janë në përputhje me dokumentat strategjik, statutin e IAL dhe të gjitha aktet e nxjerra për zbatimin e tij.</p> <p>[Annex 3.1.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022; Annex:1.2_statute-of-epoka-university, neni 3; Annex:1.2_statute-of-epoka-university, neni 3; Annex 2.3</p>

	Program Curriculum]			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Drejtimit prioritar akademike të IAL-së janë në fushën e ekonomisë, shkencave inxhinjrike, shkencave sociale dhe drejtësisë. Njësitë kryesore ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme. GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe gjatë takimit me drejtuesit e Njesisë bazë dhe Njesisë kryesore konstatoi se programi është ofruar dhe zbatohet duke u mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe departamentit, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij.			
	[Aneks:1.2_statute-of-epoka-university, neni 3; 6. Rregullorja e FEAS_final]			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Përmbajtja, struktura dhe organizimi i PS është hartuar në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për programet e studimit të ciklit të parë. Dokumentat e PS si Plani mësimor i programit dhe Rregullorja e PS japin të dhëna të plota mbi strukturën dhe përmbajtjen e PS. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave GVJ konstaton se PS është organizuar në përputhje me drejtimit akademike të institucionit.			
	[Annex 2.3 Program Curriculum; Annex 3.5.1 Regulation On Undergraduate Studies and Examinations]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Qëllimet dhe objektivat e PS janë të mbështetura në prioritetet e përcaktuara në Planin Strategjik të Njesisë bazë (2017-2022). Plani përmban objektiva specifike dhe masa në lidhje me krijimin e një mjedisi me cilësi të lartë për mësimdhënien dhe të mësuarin, rekrutimin, edukimin dhe diplomimin e studentëve; sigurimin e një mjedisi për zhvillimin me cilësi të lartë të kërkimit, etj. PS është i strukturuar në mënyrë të tillë që u siguron studentëve njohuri në menaxhimin dhe administrimin e biznesit, si dhe me aftësi organizative për të shërbyer në sektorin publik dhe privat. GVJ konstaton që objektivat e PS janë të përcaktuara qartë, janë të përshtatshme për këtë cikël studimesh

	<p>dhe bëjnë të mundur që studentët të formohen në përputhje me kërkesat e tregut vendas dhe atij global.</p> <p>[RVB fq. 14; http://bus.epoka.edu.al/home-business-administration-261-272.html]</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ <i>konstatoi që IAL nuk ka kryer vet një studim mbi tregun e punës</i>, por ka mbajtur në konsideratë shumë dokumenta politike, strategji dhe raporte për tregun e punës të hartuara nga institucione publike dhe organizata ndërkombëtare mbi zhvillimin e tregut të punës në Shqipëri.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit ka realizuar hulumtime mbi punësimin e të diplomuarve në tregun e punës, në të cilën janë përfshirë dhe studentët e këtij programi. Në nivel fakulteti, është realizuar një studim mbi “Aftësitë e të diplomuarve dhe punësimi në tregun e punës: Pritshmëritë e të diplomuarve dhe perspektiva e punëdhënësve.</p> <p>[Annex 1.4_Employment Strategies; Annex 1.5_Labor market research; Annex 1.9 Study of the Labor Market after the Exit of the Students]</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit GVJ konstatoi se struktura dhe përmbajtja e PS janë të orientuara nga nevojat e tregut të punës. Në përfundim të studimeve programi i garanton studentëve përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që u mundësojnë atyre futjen në tregun e punës. PS gjithashtu është në përputhje me strategjitë e punësimit të qeverisë shqiptare në fushën e biznesit për zgjerimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.</p> <p>[Annex 2.3 Program Curriculum]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative është një nga Njësitë kryesore që e ka filluar veprimtarinë e vet me hapjen e këtij institucioni në vitin akademik 2008-2009. Fakulteti ka</p>

<p>duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>krijuar profilin e tij dhe është konsoliduar gradualisht për t'iu përgjigjur zhvillime kombëtare në përgjithësi dhe atyre në fushën e biznesit në veçanti.</p> <p>PS ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit në bashkëpunim me dy departamentet e tjera të Fakultetit. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative për vitin akademik 2019-2020 ka gjithsej 42 pedagogë, nga të cilët 23 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 4 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 10 kanë gradën Dr./PhD, dhe 6 Asistent Lektorë me Msc; dhe 19 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 4 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD. dhe 6 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Administrim Biznesit ka 8 PAE dhe 8 PAK.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës (<i>RVBP_BA_BUS_Tabelat permbledhese_shqip.pdf, tabela nr.6.3</i>), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 32 pedagogë gjithsej, ku 21 PAE, nga të cilët 2 Prof.Dr, 3 Prof.Asoc, 9 me gradën Dr/PhD, si edhe 7 asistente-lektore me Msc, dhe 11 PAK nga të cilët 1 Prof.Dr, 2 Prof.Asoc, 3 me gradën Dr/PhD, si edhe 5 asistente-lektore me Msc.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2019-2020 rezulton 67% me 33%.</p> <p>Por pavarësisht këtij treguesi, PAE mbulon 82% të ngarkesës në auditor për këtë program studimi. Evidencat e dorëzuara dëshmojnë që mësimdhënia në këtë PS realizohet nga personel akademik i kualifikuar dhe i angazhuar në mësimdhënie në përputhje me gradat dhe titujt akademikë. Në përbërje të stafit ka personel akademik të huaj. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar PS-it.</p> <p>[Annex 2.1 Organization Scheme; RVB tabela 1.1, fq.1; Shënimet].</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Administrim Biznes” është program studimi i ciklit të parë, që i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit i përket fushës së shkencave ekonomike, me drejtim specifik në Administrim Biznes. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e</p>

<p>programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>kërkimore të Njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit (Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrim Biznesit). [Annex 1.2_statute-of-epoka-university]</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Administrim Biznes” ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, në bashkëpunim me departamente të tjera të Fakultetit. Departamenti ofron vetëm diploma në fushën e Administrim Biznesit në të tre ciklet e studimit. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë (Departamentit të Administrim Biznesit), përgjegjës për këtë PS. [Annex 1.2_statute-of-epoka-university; Annex 2.1 Organization Scheme]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë mbi hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS janë të përcaktuara në Statutin e IAL. Ato janë të ndara dhe të harmonizuara midis strukturave organizative, organeve dhe autoriteteve drejtuese. IAL vlerëson performancën e programit të studimit për çdo vit, në të cilën përfshin treguesë të performancës së mësimdhënies, hulumtimit shkencore dhe përgjigjen ndaj shoqërisë, mbështetur në raportin vjetor. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS. [Annex 1.6_Policy on Continuous Improvement of Study</p>

	Program; Annex 1.2_statute-of-epoka-university]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	<p>Universiteti Epoka ka nënshkruar 39 marrëveshje bashkëpunimi me universitete në rajon, Evropë dhe SHBA, të cilat janë shfrytëzuar për realizimin e objektivave të procesit mësimor, zhvillimin e punës kërkimore shkencore, shkëmbimin e përvojave dhe mobilitetin e studentëve. IAL ka gjithashtu 42 marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, sipërmarrje në fusha të ndryshme me qëllim mbështetjen e objektivave të procesit mësimor dhe trajnimit të studentëve. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se Njësia bazë ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e bashkëpunimit për të realizuar objektivat e përcaktuara për procesin mësimor.</p> <p>[Annex 1.8 List of Institutional Cooperations; Shënimet]</p>
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Administrim Biznesit harton një raport vjetor për çdo vit akademik. Pjesë përbërëse e raportit është dhe analiza e pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit të stafit akademik, si dhe përfitimet nga bashkëpunimi me institucione të tjera në kuadër të projekteve të ndryshme. Departamenti ka bërë gjithashtu në vitin 2020 një analizë të plotë të të gjitha marrëveshjeve gjetjet e të cilit do të përdoren për përmirësimin e PS.</p> <p>[Annex 1.12 Annual Report 2017-2018 _academic_year_BUS _department; Annex 1.13 Annual_Report_2018-2019 _academic_year_BUS_department, pikat 4.6 dhe 4.7; 35. Analysis of the Value of Cooperation Agreements for the Advancement of Study Programs in Business Administration 2020]</p>
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<p>Praktika profesionale nuk ka qënë pjesë e kurrikulës për këtë PS, por sipas vendimit të Senatit Akademik ajo është përfshirë në kurrikulën e vitit akademik 2020-2021. Në takimin me drejtuesit e Njesisë kryesore dhe njesisë bazë, si dhe nga dokumentacioni, GVJ u informua që institucioni ka marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me 42 institucione publike dhe private, një bazë shumë e mirë kjo për realizimin e praktikave të studentëve.</p> <p>[Annex 1.8 List of Institutional Cooperations; Annex Shënimet]</p>
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Referuar RVB-se, IAL ka themeluar disa qendra, ndër të cilat dhe Qendrën e Edukimit të Vazhdueshëm. Qendra mund të organizoj seminare, kurse, programe këshilluese dhe projekte jo vetëm për studentët dhe stafin e Universitetit, por edhe për palët e treta të interesuara.</p>

	<i>GVJ nga shqyrtimi i informacionit konstatoi që qendra ofron programe të trajnimit të vazhduar, por ato nuk janë të dedikuara për studentët që kanë përfunduar këtë PS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se PS Bch. në “Administrim Biznesi”, pranë Universitetit Epoka, është i organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, GVJ konstaton se PS Bsc në “Administrim Biznesi”, është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS /vit, 180 ECTS në total. Plani mësimor është i organizuar në lëndë, ku çdo lëndë vlerësohet me kredite. [DVV, Annex 2.3 Program Curriculum]
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Referuar misionit të Departamentit të Administrimit të Biznesit (Departamenti i BUS), GVJ konstaton se synohet edukimi i profesionistëve për krijimin e vlerës së lartë midis aktorëve të tregut, për rritjen e punësimit, përmirësimi i vazhdueshëm dhe qëndrueshmëria e bizneseve. Gjithashtu referuar përbërjes së planit mësimor të PS, Bsc në AB, konstatohet një diversitet lëndësh të drejtimeve të ekonomiksit, financës, kontabilitetit, marketingut dhe mbi të gjitha manaxhimit. GVJ është e mendimit se këto lëndë të këtyre drejtimeve i shërbejnë

	<p>formimit të shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh dhe mundësi punësimi.</p> <p>[DVV, 4. BUS Strategic Plan_2017-2022.pdf; Annex 2.3 Program Curriculum]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ mbasi shqyrtoi përmbajtjen e Planit Mësimor të PS Bsc. në AB, Syllabuset e lëndëve, literaturën e miratuar nga departamenti, Planin strategjik të Departamentit, si dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, por edhe me stafin e programit, është i mendimit se: Programi Bachelor në “Administrim Biznesi”, pranë Universitetit Epoka: I’u ofron studentëve njohuri të avancuara në fushën e “Administrim Biznesit” nëpërmjet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës manaxheriale për administratorët e kompanive private dhe publike.</p> <p>[DVV, 4. BUS Strategic Plan_2017-2022; Annex 2.3 Program Curriculum; 6th semester 19-20]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Referuar të njëjtave burimeve informacioni si në kriterin 3, GVJ konstaton se PS në Bsc në AB, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e manaxhimit, marketingut, kontabilitetit apo finances, me të cilat mund të ndeshen bizneset ku studentët e diplomuar të këtij programi do të jenë të punësuar.</p> <p>[DVV, 4. BUS Strategic Plan_2017-2022; Annex 2.3 Program Curriculum; 6th semester 19-20]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ mbasi shqyrtimit të planit mësimor të PS në AB, konstaton se elementët që përbëjnë strukturën e PS Bsc në AB, bazohen mbi përcaktimet e VKM 41, datë 24.01.2018 dhe analizohen më poshtë:</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>a. programi është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, ku çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS me një total prej 180 ECTS; studentit i ofrohen nga 12 lëndë gjatë vitit të parë dhe të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 10 lëndë si dhe Provimi Përfundimtar ose Projekti i Diplomës. Studentët në semestrin e tretë dhe të katërt zhvillojnë nga 1 lëndë me zgjedhje, ndërsa në semestrin e 5 dhe të 6, zhvillojnë nga dy lëndë me zgjedhje. [RVBP_BA_BUS_Tabelat permbledhese_shqip, tabela 10]</p> <p>b. Çdo lëndë e vitit të parë dhe të dytë ka nga 5 ECTS, ndërsa</p>

në vitin e tretë lëndët vlerësohen me 5 ECTS, me përjashtim të 3 lëndëve të semestrit të gjashtë, që kanë 6 ECTS dhe projektit të Diplomës që ka 7 ECTS [RVBP_BA BUS Tabelat permbledhese shqip , tabela 10]

- c. Ngarkesa javore kryesisht është 3 orë/javë, me përjashtim të 8 lëndëve të cilat kanë ngarkesë javore 4 orë/javë. GVJ është e mendimit se ndarja e ngarkesës dhe e krediteve është e duhura. GVJ e cilëson të duhur diferencimin në ngarkesë orare mes lëndëve dhe konstaton se lëndët që kanë më shumë orë në auditor janë lëndë të karakterit teknik, të cilat kanë nevojë për më tepër shpjegim dhe ushtrim të studentit në auditor, sesa punë të pavarur.

[RVBP_BA BUS Tabelat permbledhese shqip , tabela 10]

- d. Plani mësimor konstatohet se ka të përcaktuara dhe të deklaruara objektivat formuese që synohet të arrihen si dhe kompetencat profesionale që synohet të fitojnë studentët në përmbyllje të studimeve të tyre në PS Bsc AB

- e. Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtareve formuese nga A-E. Veprimtaritë formuese të tij janë të përcaktuara dhe GVJ konstaton se:

- lëndët bazë (kategoria A) kanë 35 ECTS ose 19.5% të krediteve,
- lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 91 ECTS, ose 50.5 % të krediteve,
- lëndët integruese (kategoria C) që zënë 12% të krediteve,
- lëndët plotësuese (kategoria D) 14% të krediteve,
- kategoria E e detyrimeve përmbyllëse përmban 7 kredite ose 4% të krediteve të PS. [RVBP_BA BUS Tabelat permbledhese shqip, tabela 10]

- f. GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2). Ato janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion/seminar.

- g. Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës.

[RVBP_BA BUS Tabelat permbledhese shqip. ; BUS CURRICULUM ; 6th semester 19-20 ; Annex 3.8.8 Diploma Format BA BUS ; Annex 3.8.85b BUS-BA-suplement-diplome (3 years, 18.12.2013)]

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ referuar informacionit në systemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Universiteti Epoka është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhrit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 92, datë 20.10.2017, të Bordit të Akreditimit.</p> <p>PS Bsc në AB, është akredituar me Vendimim të BA, Nr. 96, datë 20.10.2017.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>GVJ mbështetur në informacionin e depozituar në DVV, në statutin e institucionit si dhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion konstaton se Përgjegjësi i Departamentit është njëkohësisht edhe koordinatori i PS Bsc në AB dhe përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/Statute_Uni_EPOKA_en; 36.Program Coordinator]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSHEA), ka në përbërje tre departamente;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Financë – Bankës; 2. Departamenti i Administrim –Biznesit; 3. Departamenti i Ekonomiksit; <p>Departamenti i Administrim Biznesit ofron studime në shtatë programe, tre të ciklit të parë bachelor, dy të ciklit të dytë dhe një program studimi të ciklit të tretë.</p> <p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për PS Bsc AB, janë të përcaktuara në</p>

<p>kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”.</p> <p>FSHEA në vitin e fundit akademik 2019-2020, ka në përbërje të tij 42 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 23 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 19 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2019-2020:</p> <p><u>Departamenti i Administrim Biznesit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 8 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada; - 8PAK, ndër të cilët, 5 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Financë – Bankës:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 8 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada; - 10 PAK, ndër të cilët 8 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Ekonomiksit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada; <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Admministrim Biznesit që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018, (8 PAE / 5 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 1;</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (7 PAE/ 3 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 5 / 2;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (8 PAE / 8 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 6 / 5;</p> <p>Përsa më sipër GVJ konstaton se të tre njësitë bazë, plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHEA) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik - organizimin dhe strukturën akademike. <p>[Annex 2.1 Organization Scheme; RVBP_BA BUS_Tabelat permbledhese_shqip, tabela 1,2,3]</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se FSHEA dhe DBUS, zotërojnë informacionin e plotë lidhur me PS Bsc në AB, siç është plani mësimor, informacion mbi strukturën akademike, informacion mbi rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj. Këto informacione ju vendosën në dispozicion edhe GVJ.</p> <p>[Annex 2.3 Program Curriculum; Annex 2.2 Information on Academic Staff of Study Program; Annex 2.5 Teaching Assistants; Annex 2.1 Organization Scheme; Annex 3.6.7b Undergraduate Studies Academic Calendar 2019-2020]</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar planit mësimor të PS, Bsc në AB, konstatohet se plani mësimor është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018. Çdo lëndë vlerësohet me kredite, çdo lëndë ka të përcaktuara orët javore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Plani aktual nuk përmban praktikë mësimore. Ky është një rekomandim i lënë nga akreditimi i mëparshëm, të cilin institucioni e ka marrë në konsideratë dhe ka ndryshuar planin mësimor për vitin e ri akademik, 2020-2021.</p> <p><i>GVJ është e mendimit që ky rekomandim nga ana e institucionit të ishte marrë në konsideratë më herët, duke iu krijuar mundësinë studentëve të dy viteve akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 të kishin praktikën profesionale pjesë të kurrikulës së tyre të studimit.</i></p> <p>[Annex 2.3 Program Curriculum]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, GVJ konstaton se programi Bachelor në "Administrim Biznesi" është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 180 ECTS. Studentit i ofrohen nga 12 lëndë gjatë vitit të parë dhe të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 10 lëndë si dhe Provimi</p>

	<p>Përfundimtar ose Projekti i Diplomimit.</p> <p>[Annex 2.3 Program Curriculum]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit bachelor në Administrim Biznes, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj.</p> <p>[Annex 2.3 Program Curriculum; 6th semester 19-20; Annex 3.8.8 Diploma Format BA BUS; Annex 3.5.3 Guideline “On Examinations“]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ referuar rregullores së programit, guidës së studentëve, si dhe takimeve me studentët, konstaton se PS Bsc në AB ka informacion të plotë për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Sipas Rregullores së Studimeve dhe Provimeve, ku janë të sanksionuara kriteret e pranimit në këtë program studimi, rezulton se studentët shqiptarë, pranohen në fakultetet e Universitetit Epoka, sipas rezultateve të provimit të hyrjes dhe mesatares së shkollës së mesme, ndërsa studentët e huaj pranohen sipas vendimit të rektoratit mbi propozimet e Fakulteteve, për kuotat e studentëve të huaj.</p> <p>Në rregulloren e sipërcituar, paraqitet informacion i plotë për transferimet e studimeve nga IAL të tjera dhe transferimet brenda Universitetit Epoka, ku studenti duhet të ketë përfunduar të paktën një semestër në programin, ku është regjistruar që të ushtrojë të drejtën e transferimit në programe të tjera. (Regulation On Undergraduate Studies and Examinations, fq 10)</p> <p>[Annex 3.5.1 Regulation On Undergraduate Studies and Examinations; Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2019-2020]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me</p>	<p>Referuar DVV, syllabuseve të lëndëve, rezulton se ato janë në përputhje me VKM nr. 41, dt.24.01.2018 dhe ofrojnë informacionin e nevojshëm për studentët. GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve, ngarkesën javore si dhe detyrimet lëndore.</p> <p>[Syllabuset 6th semester 19-20]</p>

formatet e miratuara.				
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ është e mendimit se ndryshimet e vazhdueshme të planit mësimor, të syllabuseve, të literaturës, janë në zbatim të bazës ligjore por edhe të sanksionuara në politikën e përmirësimit të vazhdueshëm, që institucioni ka dhe janë tregues të plotësisht të këtij kriteri [Curriculum Changes Table BA BUS 14-02-2020; 3-Policy on Continuous Improvement of Study Program]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se, PS Bsc në AB, përmban <ul style="list-style-type: none"> - 180 Kredite, - Çdo vit ka 1500 orë në total sipas shpërndarjes më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> -Viti i parë dhe i dytë 640 orë në auditor /860 orë jashtë auditorit; -Viti i tretë, 528 orë në auditor /972 orë jashtë auditorit; GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. [Annex 2.3 Program Curriculum]
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	GVJ duke iu refruar përmbajtjes së PS, emërtesës së lëndëve, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të siguruar nga takimet me stafin akademik dhe studentët e programit është e mendimit se, PS mundëson njohuri dhe aftësi të diversifikuara për studentët, e mundësuar kjo edhe nga 6 lëndë me zgjedhje prej një game të gjerë lëndësh të tjera. <i>Pavarësisht për sa më sipër, gjatë 2 viteve akademike të mëparshme, institucioni duhej të kishte vlerësuar mundësinë e përfshirjes më herët të praktikës mësimore, për aftësim praktik por edhe për mundësi më të larta punësimi.</i>

	[Annex 2.3 Program Curriculum; Sylabusët 6th semester 19-20]
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.	GVJ është e mendimit se shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Shpërndarja e ngarkesës është homogjene mes semestrave të ndryshëm, dhe viteve të ndryshme duke mos krijuar ngarkesë të zbalancuar për studentët. Shpërndarja e lëndëve, është e tillë që në vitin e parë mundëson kryesisht formimin bazë, ndërsa në vitin e dytë dhe të tretë thellim në disiplinat karakterizuese të programit, duke krijuar edhe mundësinë e lëndëve me zgjedhje me qëllim thellimin dhe diversifikimin e njohurive. [Annex 2.3 Program Curriculum]
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Duke iu referuar edhe informacionit të siguruar në institucion nga drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore si dhe nga DVV, shpërndarja lëndore, numri i lëndëve, kreditet e çdo lënde, rezultojnë të ngjajshëm me programe të përafërta të universiteteve gjermane ose italiane. [Annex 2.3 Program Curriculum ; RVB; Vizita në institucion]
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ nga shqyrtimi i Kurrikulës së Programit, konstaton se për vitin akademik 2019-2020, ngarkesa në auditor është 1840 ore, ndër të cilat 1792, orë janë leksione dhe 48 orë Projekti i Diplomës. Për vitin 2020-2021, në planin mësimor të miratuar, janë parashikuar 1808 orë, ndër të cilat 1744 janë leksione, 16 orë janë praktikë profesionale dhe 48 Projekti i Diplomës [Tabela 9]. <i>Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me studentët dhe stafin e programit, rezultoi se gjatë seancave mësimore janë të integruara leksionet dhe rastet studimore, prezantimet, detyra individuale, ushtrimet, në varësi të natyrës së lëndëve.</i>
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Referuar DVV dhe takimeve me stafin akademik, rezultojnë se sylabusët përditësohen vazhdimisht, si detyrim ndaj kërkesave ligjore por edhe si rezultat i një mjedisi biznesi tejet të ndryshueshëm, azhurnimit të literaturës, përfshirje të modeleve të avancuara në biznes, marketing, teknologji etj. [Annex 2.3 Program Curriculum; RVB; Vizita në institucion]
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e	Lëndët që janë në përbërje të PS, si Manaxhim Operacionesh, Manaxhim i Burimeve Njerëzore, Manaxhim i Njohurive, Kërkim Marketing, Manaxhim Total i Cilësisë, Sjellje Organizative, Manaxhim i Forces Shitëse, etj, garantojnë

studimit të ciklit të parë.	përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për administratorë biznesi. [Annex 2.3 Program Curriculum]			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Mundësia për të marrë 6 lëndë të ndryshme me zgjedhje, ofrimi i lëndëve bazë formuese dhe karakterizuese, iu ofron studentëve njohuritë kryesore në përputhje me nivelin bachelor, por krijojnë mundësi për studime të mëtejshme në nivelin master të të njëjtit drejtim, por edhe të drejtimeve të tjera të përafërta. [Annex 2.3 Program Curriculum]			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Referuar DVV, vizitës në institucion si dhe webit të Universitetit “Epoka”, rezulton se Zyra e karrierës dhe Alumnit, organizon panairë të karrierës, në të cilat institucionet dhe kompanitë e interesuara, kanë mundësinë të mund të përzgjedhin prej studentëve më të mirë si punonjës të ardhshëm. Kjo është mundësi për institucionin për të kuptuar më mirë kërkesat e tregut të punës si dhe për të adresuar në të ardhmen ndryshime në planin mësimor në përputhje me kërkesat e tregut të punës [http://cpao.epoka.edu.al/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Referuar dokumentit [Annex 2.2 Information on Academic Staff of Study Program, Tabelat 3.1, 3.2 dhe 3.3], të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë: Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 32 pedagogë ndër të cilët 21 PAE dhe 11 PAK .
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë	Mbulimi i programit në përqindje është 66% PAE dhe 34% PAK . Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 19 pedagogë ndër të cilët 15 PAE dhe 4 PAK .

nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Mbulimi i programit në përqindje është **79% PAE dhe 21% PAK.**

Për vitin akademik **2017-2018** janë të angazhuar **19** pedagogë ndër të cilët **14 PAE dhe 5 PAK.**

Mbulimi i programit në përqindje është **73% PAE dhe 27% PAK.**

Për sa i përket kualifikimeve të PA:

- Për 2017-2018, 42% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 58% janë Msc;
- Për 2018-2019, 63% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 37% janë Msc;
- Për 2019-2020, 63% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 37% janë Msc.

Referuar përbërjes sasiore dhe cilësore, të stafit akademik të PS për tre vite akademike, Bsc në AB, rezulton se stafi ka ardhur duke u rritur si rezultat edhe i shtimit të numrit të studentëve të PS, gjithashtu edhe përfshirja e stafit akademik me tituj dhe grada ka ardhur duke u rritur.

[Annex 2.2 Information on Academic Staff of Study Program]

Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstaton se për të tre vitet akademike, 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020, programi:

- përmbush kërkesën ligjore për stafin akademik që të jetë të paktën 70 % të jenë staf efektiv (VKM 418, Maj 2017). Gjatë vitit akademik 2019-2020, pavarësisht se stafi i brendshëm është 66% e stafit të programit, por referuar shpërndarjes së lëndëve, tabela 6 , rezulton se stafi efektiv mbulon 82% të ngarkesës së programit.

[Annex 2.2 Information on Academic Staff of Study Program, Tabela 6]

- përmbush kërkesën ligjore të të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për të gjithë stafin akademik që mbulon programin akademik;
- niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Pavarësisht kësaj përputhshmërie, vihet re një numër i lartë i lëndëve të ndryshme, që mund të jap një pedagog, që arrin deri

	<p>në 7 lëndë të ndryshme brenda programit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni të vlerësojë një shpërndarje më optimale të lëndëve, duke ulur numrin e lëndëve për pedagog, e cila krijon zbalancim mes ngarkesës mësimore dhe mundësisë për kërkim shkencor të stafit.</i></p>
--	---

<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p><i>Institucioni për këto vite që ky program akreditohet, nuk e ka pasur praktikën pjesë të kurrikulës së tij. Pavarësisht kësaj institucioni ka angazhuar personelin e duhur për instruktimin dhe udhëheqjen e studentëve të diplomës, që siç rezultoi edhe nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, organizojnë disa takime grupi dhe individuale me studentët, i orientojnë ata për zgjedhjen e temës, ndërtimin e strukturës, rishikimin e literaturës, metodologjinë, për shmangien e plagjaturës në punim etj.</i></p>
---	---

<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion si dhe nga konsultimi me informacionin në sistem, se përveç stafit akademik, në ndihmë të procesit mësimor, institucioni angazhon edhe asistentë të mësimdhënies, të cilët asistojnë stafin akademik gjatë mëimit, si dhe studentët e programit për nevojat që ata kanë në lidhje me lëndë të caktuara. edhe stafi ndihmës rezulton me angazhim maksimal për realizimin</p> <p>[Annex 2.5 Teaching Assistants]</p>
--	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	GVJ mbështetur në “Kornizën e Strategjisë 2018-2022 të Universitetit EPOKA” si dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, konstaton se në strategjinë e institucionit, janë përcaktuar si qëllime prioritare përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies. Gjithashtu institucioni zhvillon trajnime të vazhdueshme për të përmbushur këtë qëllim. [DVV <u>Annex 3.1.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022</u> ; <u>Annex 3.1.1b Epoka University ACADEMIC TRAINING ON DIGITAL EDUCATION</u> ; Vizita në institucion <u>5-Final_training_Agenda</u>]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ konstaton se institucioni aplikon forma të diversifikuara të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike, të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga përgjegjësi i departamentit si dhe nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Gjithashtu studentët çdo fund semestri plotësojnë nëpërmjet sistemit EIS, pyetësozin për çdo lëndë/pedagog, ku midis termave të tjerë vlerësojnë edhe aftësitë mësimdhënëse. [<u>40 Course Instructor Evaluation Survey Questionnaire</u>]
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, në dokumentacionin në sistemin e informacionit të ASCAL, në informacionin e siguruar nga takimi me studentët e programit, rezulton se institucioni i përfshin studentët në forma të ndryshme në vlerësimin periodik, nëpërmjet plotësimit të anketës çdo semestër/pedagog si dhe nëpërmjet informacionit që studentët paraqesin për problematika të ndryshme tek Dekani i studentëve. Studentët rezultojnë të kenë të drejtën e apelimit të notes, nëse kanë pakënaqësi rreth vlerësimit etj. [<u>40 Course Instructor Evaluation Survey Questionnaire</u> ; <u>BA in BUS Course Instruction Survey Results</u> ; <u>BA in BUS Course Instruction Survey Results</u>]
Kriteri 4. Strukturat	Monitorimi dhe sigurimi i cilësisë në Universitetin Epoka, për

përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	PS Bsc në AB, rezultojnë të jenë procese periodike, rezultatet e të cilave publikohen si pjesë e raporteve vjetore, në webin e institucionit. [http://epoka.edu.al/home-staff-annual-reports-6-48.html]			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ është e mendimit se Universiteti “Epoka”, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit identifikon praktikat e mira të vlerësuara prej studentëve dhe i promovon ato, nëpërmjet shpërndarjes së informacionit në burime të ndryshme nëpërmjet website të tij, nëpërmjet email-it tek stafi akademik etj. Gjithashtu për të promovuar përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se institucioni realizon trajnime të vazhdueshme [3-Policy on Continuous Improvement of Study Program; 8-Report of the Workshop on Course Design and Syllabus Development; 1-Decision of the Rectorate on the Workshop Proposal of the NJSBC]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e</p>	<p>GVJ duke iu referuar përmbajtjes së syllabuseve, planit mësimor si dhe informacionit të marrë gjatë takimeve me stafin dhe studentët e PS Bsc në AB, konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë të diversifikuara, të tilla janë leksione, seminare, detyra grupi, detyra individuale, prezantimet, rastet studimore, përdorimi i mjeteve multimedia, vizita studimore në kompani të ndryshme etj, për t’iu përgjigjur edhe diversitetit dhe nevojave të studentëve</p> <p>Në planin mësimor, rezultojnë orë mësimore në auditor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 1760 orë mësimore - Projekt i Diplomës 48 orë në auditor - Gjithsej në auditor 1808 orë mësimore <p>[Annex 2.3 Program Curriculum]</p> <p>Referuar DVV, syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me</p>

<p>programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>stafin e programit, por edhe me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se institucioni nëpërmjet trajnimeve, por edhe pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, synon të nxisë personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike</p> <p>[<u>Policy on Continuous Improvement of Study Program; Evaluation of the Workshop on Course Design and Syllabus Development;</u></p> <p>http://aeqi.epoka.edu.al/cat-training-activities-1411.html]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Duke iu referuar CV të stafit akademik, por edhe informacionit të siguruar gjatë takimeve me stafin akademik dhe me studentët e programit Bsc në AB, rezulton se stafi është kompetent për njohuritë dhe konceptet që shpjegon. Ata rezultojnë të përdorin forma alternative të mësimdhënies, sipas lëndëve të ndryshme por edhe diversitetit të studentëve. Institucioni, mbështet duke iu ofruar infrastrukturën e duhur, pajisjet kompjuterike, mundësi mbulimi me internet, pajisje audio-vizive që këto forma alternative të mësimdhënies të implementohen.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Perceptimi i studentëve mbi metodat e mësimdhënies, rezulton të përdoret në mënyrë frekvente, dy herë në vit, para përfundimit të semestrit. Studentët plotësojnë në mënyrë të detyrueshme anketën për vlerësimin e instruktorit, duke paraqitur edhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit rezultoi se stafi akademik, përdor metoda interaktive për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve dhe për të rritur efektivitetin e seancave mësimore.</p> <p>[<u>Annex 3.1.2 Course Instructor Evaluation Survey</u>]</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhëniesve të</p>	<p>GVJ është e mendimit se, format alterantive të mësimdhënies, metoda tradicionale të kombinuara me metoda inovative, që konstatohet se përdoren nga stafi akademik, krijojnë mundësi të udhëheqjes së studentit, angazhimit të tij, rritjes së iniciativës, mbështetjes së studentit për të përmbushur detyrimet lëndore, por edhe krijimit të respektit të ndërsjelle mes stafit akademik dhe studentëve.</p>

respektit të ndërsjellë mes tyre.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga informacioni i depozituar në DVV, konstaton se procesi mësimor i PS BSc. në AB, realizohet në hapësira të mjaftueshme, cilësore, higjenike dhe që mirëmbahen rregullisht [Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Sallat e leksioneve dhe seminareve rezultojnë, të jenë të pajisura me pajisjet hardware dhe software, me pajisjet audio-vizive si dhe kanë mbulim me internet, duke mundësuar kushte optimale për procesin mësimor. [Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me Stafin akademik dhe studentët, rezultoi se ata kanë në përdorim infrastrukturë të konsoliduar IT, të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Të tilla janë aksesit në sistemin EIS, aksesit në sistemin LMS, në Google classroom, në rrjetin e brendshëm të email-it si dhe në softet e ndryshme pranë laboratorëve informatikë, për të përmbushur detyrimet e ndryshme lëndore.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	GVJ është e mendimit, se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të për Bch. në AB. Kjo literaturë pasurohet vazhdimisht, si kërkesë imperative e pasqyrimin në syllabus të një literature të 5 viteve të fundit, por e ndikuar edhe nga dinamizmi i mjedisit global të të bërit biznes, ekspozimit ndaj modeleve inovative të biznesit etj. [Syllabuset e lëndëve; List of Books BUS.xlsx; 45.1 Library Annex (1)]
Kriteri 5. Biblioteka e	Biblioteka e institucionit ka një kapacitet prej 100 vendesh, ka

<p>institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>infrastrukturën e duhur në dispozicion të studentëve dhe GVJ konstaton se ajo pasurohet në mënyrë të vazhdueshme nga blerjet e sugjeruara nga pedagogët e lëndëve, departamenti, nga dhurimet etj. Librat mund të gjënden fizikisht, por rezulton se për stafin akademik mund të aksesohet edhe data baza elektronike e JSTOR.</p> <p>Biblioteka pasurohet edhe nga depozitimi i publikimeve të stafit akademik të institucionit.</p> <p>[Request for books 2019-2020; List of Books BUS; 45.1 Library Annex (1); Publications of Academic Staff_2018-2019]</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, krijon mundësinë që studentët të aksesojnë library on-line si, JSTOR. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion, rezultoi se stafi akademik zotëron edhe individualisht akses në biblioteka të ndryshme elektronike, prej të cilave siguron materiale të azhornuara.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me studentët e programit, si dhe nga kapacitetet infrastrukturale, rezulton se pavarësisht se në këtë program nuk ka laboratore, por për përgatitjen e projekteve të kursit, të projektit të Diplomës apo detyrime të tjera lëndore, studentët aksesojnë programe softwerike të ndryshme, kanë mbulim me internet si dhe një sallë biblioteke me kompjutera është në funksion të tyre. Këto elementë i shërbejnë përmbushjes së këtij kriteri.</p> <p>[Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimet me stafin dhe studentët, rezultoi se ata përdorin disa forma alternative të platformave elektronike, përdorimi i të cilëve u intensifikua si rezultat i situatës pandemike dhe domosdoshmërisë së zhvillimit të mësimin online.</p> <p>Rezulton se përdoret sistemi LMS si dhe platforma google classroom.</p> <p>Në sistemin LMS çdo student ka akses dhe merr materialet mësimore të lëndëve të ndryshme, apo depoziton detyrat lëndore. Google classroom nga ana tjetër, rezulton se është duke u përdorur për të krijuar klasa virtuale dhe për të garantuar një zhvillim të procesit mësimor të klasave të ndryshme on-line.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik</p>	<p>Referuar RVB, takimeve me stafin dhe studentët e programit,</p>

dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	ka disa forma alternative të komunikimit të brendshëm. Çdo student është i pajisur me një email, nga ana tjetër nëpërmjet sistemit LMS, siguron materialet lëndore, leksione, prezantime ppt, etj. Në sistemin EIS, rezulton se çdo student mund të konsultojë rezultatet e lëndëve, statusin etij, mund të plotësojë anketën për çdo pedagog, etj.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studentët kanë të drejtën të mbikqyren nga një pedagog udhëheqës. Nga takimi me stafin akademik por edhe studentët, rezulton se personeli akademik, orienton studentin në zgjedhjen e temës, zhvillon me këta studentë seanca metodologjike, takime grupi apo edhe individuale. Studenti para mbrojtjes së diplomës, ka detyrimin e kontrollit të plagjaturës. Rezulton se Universiteti Epoka, përdor për këtë qëllim, software Turnitin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ duke u mbështetur në DVV, në informacionin në sistem, në webin e institucionit si dhe në takimet me strukturat drejtuese dhe NJSBC, konstaton se institucioni ka ngritur struktura në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Struktura të tilla janë: - Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (PCQA); - Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë; - Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave; - Bordi i Provimeve; Këto struktura kanë marrëdhënie hierarkike mes tyre dhe janë në nivel institucional. Detyrat e secilës njësi janë të sanksionuara në statutin e institucionit. Ato operojnë bazuar në këtë statut si dhe në Rregulloren për funksionimin e PCQA në Universitetin Epoka dhe në zbatim të politikës për sigurimin e cilësisë të referuar në vijim, duke integruar funksionet e tyre në

	<p>shërbim të sigurimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>[<u>Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA; Quality Policy</u>]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Nga takimi me strukturat drejtuese si dhe nga informacioni i depozituar në DVV, GVJ është e mendimit se njësia bazë mbështet dhe nxit proceset, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së PS Bsc në AB.</p> <p>Institucioni rezulton të ketë një politikë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe strukturat demonstrojnë kryerjen e aktiviteteve në vënien në zbatim të kësaj politike, siç janë trajnimet e zhvilluara, ku stafi i programit merr pjesë.</p> <p>[<u>Policy on Continuous Improvement of Study Program; 4- Decision on the Training; 7-Evaluation of the Workshop on Course Design and Syllabus Development</u>]</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion si dhe takimeve me përfaqësues të strukturave drejtuese, rezulton se ata synojnë të mbështesin dhe të nxisin përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Një nga arsyet për rekrutimin e stafëve nga kultura të ndryshme, është edhe mundësia për të pasur edhe një diversitet në këto metoda inovative të aplikuara në vende të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimet me stafin e programit, rezulton se institucioni mbështet stafin në kualifikimin e vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor, duke i shërbyer kështu ngritjes shkencore të stafit, objektivave akademike të tyre dhe që reflektohen edhe në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Duke iu referuar web-it të institucionit, informacionit në DVV, dhe atij të siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultojnë disa trajnime të kryera për këtë qellim, si më poshtë:</p> <p>[<u>Announcement of the Training _ ACADEMIC TRAINING ON DIGITAL EDUCATION; News on the Announcement of the WORKSHOP ON COURSE DESIGN AND SYLLABUS DEVELOPMENT; Attendance List of Participants- 2019 09 26; Sample of the Certificate Delivered to Participants</u>]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Siç u shpreh edhe në kriterin 4, NJSBC organizon trajnime apo workshop me trajnues vendas ose ndërkombëtarë, për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave inovative.</p> <p>GVJ siguroi informacion bazë për këto trajnime në DVV dhe një informacion më të detajuar gjatë vizitës në institucion, për tematikën, pjesëmarrësit, vlerësimin e këtyre trajnimive etj, të</p>

	<p>referuara si më poshtë;</p> <p>[<u>Survey Results about the training on digital education 07-10-2019-converted</u>; <u>News on the Announcement of the WORKSHOP ON COURSE DESIGN AND SYLLABUS DEVELOPMENT</u>; <u>Attendance List of the Participants-2019 09 27-Day 2 of the Workshop</u>]</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Mbështetur në listat e pjesëmarrësve të trajnimeve të zhvilluara nga NJSBC, rezultoi se stafi akademik i programit të studimit Bsc në AB, merr pjesë aktive në trajnimet e zhvilluara nga institucioni për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Siç rezultoi nga takimi me stafin dhe studentët, ata aplikojnë marrjen e feed-back nga studentët pas paraqitjes së programit dhe mënyrës së organizimit dhe implementimit të tij.</p> <p>[Vizita në institucion, <u>Attendance List of Participants- 2019 09 26.</u>; <u>Attendance List of the Participants-2019 09 27-Day 2 of the Workshop</u>]</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik, rezultoi se personeli akademik përdor kombinime mes metodave tradicionale dhe atyre inovative të mësimdhënies. Gjithashtu referuar RVB, stafi akademik në fund të semestrit, realizon një vlerësim lidhur me efektin e kursit në objektivat e programit si dhe arritjet në kompetencat e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni sanksion mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale në rregullore. GVJ konsultoi rregulloren e programit e cila jep informacion prej vlerësimit në nenet 16-23.</p> <p>Referuar web-it të institucionit, kjo rregullore bëhet publike. Referuar takimit me studentët, rezultoi se ata kishin</p>

	<p>informacion rreth mënyrës së vlerësimit të provimeve dhe të drejtave që ata kishin lidhur me vlerësimin apo ankimimin.</p> <p>[Annex 3.5.1 Regulation On Undergraduate Studies and Examinations]</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/regulations/undergraduate-education-and-examination]</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se stafi akademik, gjatë seancës së parë të semestrit, prezanton syllabusin, temat, literaturën, metodologjinë e vlerësimit gjithësemestral. GVJ e gjykon një praktikë të mirë marrjen e feedback nga studentët, mbas prezantimit të syllabusit prej pedagogëve të lëndës, për të rritur reagueshmërinë si dhe angazhimin e tyre gjatë semestrit.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Duke iu referuar DVV, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion rezultoi, se për të gjitha lëndët vlerësimi është gjithësemestral dhe përfshin forma të ndryshme vlerësimi, si projekte, pjesëmarrje, kuize, mid term, provim final etj.</p> <p>GVJ është e mendimit se këto forma të ndryshme vlerësimi, nxisin angazhimin e studentit, janë në përputhje me diversitetin e studentëve dhe të nivelit të tyre të angazhimit. GVJ konstaton nga syllabuset e lëndëve që, pesha specifike e çdo komponenti në vlerësim është e ndryshme nga lënda në lëndë, duke krijuar një përputhshmeri më të mirë të metodës së kontrollit të dijeve me natyrën e lëndës, por respekton edhe lirinë akademike të stafit.</p> <p>[6th semester 19-20, etj.]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë</p>	<p>Mbështetur në syllabuset e lëndëve si dhe në informacionin e siguruar gjatë takimit me studentët e programit, GVJ konkludon se vlerësimi është gjithë semestral, me komponente</p>

gjithë vitit akademik.	të tillë si detyra individuale, detyra kursi, mid term dhe provimi final etj. Të gjithë komponentët reflektohen në vlerësimin final. Skema e vlerësimit rezulton e ndryshme në lëndë të ndryshme. [3rd semester 19-20; http://eis.epoka.edu.al/curricula/21/program]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar rregullores si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, rezulton se provimet zhvillohen duke ruajtur anonimitetin. Sistemi EIS gjeneron një kod sekretimi për çdo student. Kjo siguron objektivitet në korrigjim dhe në vlerësim.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Referuar rregullores së provimeve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, kjo në varësi të numrit të studentëve, për të shmangur sjelljet joetike nga ana e studentëve. [Annex 3.5.3 Guideline “On Examinations“; Annex 3.6.2d Smart Student Guide 2019-2020 Section 23-1; Annex 3.6.2b 01-Code of Ethics]
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Nga takimet në institucion, rezulton se provimet zhvillohen në mënyrë anonime, të kodifikuara nëpërmjet sistemit EIS. [Annex 3.6.3 Guideline “On Examinations“] Gjithashtu institucioni vendos në dispozicion kamera survejimi, për të shmangur sjelljet joetike. Kjo mënyrë monitorimi rezulton të jetë e sanksionuar në rregullore të posaçme dhe e publikuar në web.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultoi se tezat e provimit, përveç vlerësimit me pikë për seksionet e ndryshme, ata i shoqërojnë ato me komente rreth saktësisë së përgjigjeve, orientuese për riprovimet, por edhe për të pasur një proces objektiv dhe të argumentuar vlerësimi. Referuar DVV, rezulton se institucioni ka ngritur një strukturë siç është Bordi i Provimeve, që ka si funksion kryesor monitorimin e objektivitetit në vlerësimin e provimeve. [Annex 6.8-Directive “On the Functioning of the Exam Board“]
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk	GVJ konstaton se, institucioni përdor sistemin Turnitin, për të shmangur plagjiaturën, e ndihmuar kjo edhe nga zhvillimi i programit në gjuhën angleze. Gjithashtu provimet monitorohen fizikisht nga stafi akademik, si dhe mbikqyren

tolerohen nga personeli akademik.	nëpërmjet kamerave të survejimit. Edhe Kodi i Etikës i Institucionit i mëshon një hapësirë të rëndësishme çështjeve të mos kopjimit.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se stafi akademik bën vlerësimin e studentëve sipas skemës së vlerësimit, pasqyruar në syllabuset e lëndëve. Vlerësimet mbështeten mbi meritë. Për të siguruar vlerësimin mbi meritë, bëhen kontrole nga bordi i provimeve. Studentët kanë të sanksionuar të drejtën e ankimit në rregulloren e provimeve dhe rezultojnë se e ushtrojnë atë. [Annex 6.9-Guideline “On Examinations“; Annex 6.8-Directive “On the Functioning of the Exam Board“]			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga takimi me studentët rezultoi se ata informohen për vlerësimin nëpërmjet sistemit EIS, mbasi ata kanë plotësuar anketën për vlerësimin e pedagogut. Studentët informohen në syllabusin e lëndës, në rregulloren e provimeve si dhe nga guida e studentit. Të tre këto dokumenta janë të publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit. [Annex 3.6.2d Smart Student Guide 2019-2020 Section 23-1; Annex 3.6.3 Guideline “On Examinations“]			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas informacionit të siguruar nga takimi me studentët dhe nga (3.6.3 Guideline “On Examinations), rezultojnë se studentët mund ta paraqesin kërkesën për rishikim tek pedagogu i lëndës, i cili mbas shqyrtimit e reflekton në vlerësimin përfundimtar. Studentët mund të paraqesin ankesën, edhe tek dekani i studentëve, në një format më të formalizuar, në vijim fakulteti ngre një komision ad-hoc për shqyrtimin e ankesës së studentit. Institucioni e dokumenton procedurën e rishikimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë	Mbështetur në PS, GVJ është e mendimit se përbërja e planit mësimor si dhe zhvillimi i lëndëve garantojnë mundësinë për thellimin e njohurive, si dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve, në drejtim të manaxhimit të organizatave të

profesionale dhe të veçanta të studentëve.	biznesit dhe atyre publike, në fushën e marketingut etj.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaton se PS Bsc në AB, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën <ul style="list-style-type: none"> - e teknologjisë së informacionit nëpërmjet lëndëve si Manaxhim i Sistemeve të Informacionit, - humane sociale, nëpërmjet lëndëve si hyrje në sociologjinë politike, - e komunikimit dhe ndërveprimit, nëpërmjet lëndëve si aftësi komunikuese, gjuhë angleze, franceze dhe turke etj. <p>[Annex 2.3 Program Curriculum]</p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimi me studentët e programit Bsc në AB, rezultojnë se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, institucioni siguron informacion mbi cilësinë e aftësive që ata fitojnë. Gjithashtu vetë institucioni, realizojnë një analizë të provimeve përfundimtare dhe të rezultateve të studentëve, për të monitoruar kalueshmërinë, cilësinë, frekuencën etj.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit çdo pedagog realizojnë një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që kanë studentët.
Kriteri 5. Personeli akademik realizojnë orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, se stafi akademik i programit Bsc në AB, kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës, siç është [Annex 3.1.1b Epoka University <u>ACADEMIC TRAINING ON DIGITAL EDUCATION</u>]. Gjithashtu referuar webit të institucionit, rezultojnë se stafi i programit zhvillon seminare apo debate të ndryshme jashtëkurrikulare. [http://bus.epoka.edu.al/event-debate-to-be-an-engineer-or-an-economist-2850.html]
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të	Referuar PS Bsc në AB, planit mësimor, syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezultojnë se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi, i

zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruara nga teoria.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Mbështetur në informacionin e siguruar gjatë takimeve me stafin akademik, studentët e PS, por edhe syllabuseve, stafi akademik, inkurajon, nxit dhe mbështet punën në grup të studentëve, për rastet studimore dhe për projektet e kursit. [3rd semester 19-20]			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të zyrës së projekteve rezultoi se nëpërmjet Qendrës Yunus për Biznes Social dhe Qëndrueshmëri dhe Zyrës për Kërkim Shkencor dhe Projekte, institucioni informon stafin akademik edhe studentët për mundësi të përfshirjes së tyre në ide inovative, nxit dhe lehtëson angazhimin e tyre. [Annex 3.7.9b Epoka University _ 3rd Call for Internal Scientific Research Projects; Annex 3.7.7 Startup and Entrepreneurial Achievements of Epoka Students 10 February 2020]			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Universiteti EPOKA, ofron mbështetje financiare për stafin akademik, për t'u mundësuar atyre të marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe të botojnë në revista shkencore. Universiteti EPOKA gjithashtu ofron mbështetje financiare për kërkimin shkencor nga studentët, ku në projektet që stafi zhvillon, sugjerohet edhe përfshirje e studentëve [Annex 3.7.9 DIRECTIVE "ON THE PROMOTION OF SCIENTIFIC PUBLICATIONS"]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ nga konsultimi i DVV konstaton se Universiteti Epoka, ka marrëveshje të ndryshme për mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve, duke siguruar diversifikim të eksperiencës mësimdhënëse në dhe nga vende të ndryshme. Studentët janë përfshirë në programe shkëmbimi në universitete të ndryshme perëndimore si në, Universitetin e Salerno, Itali dhe Universitetin e Lille, Francë etj. [Annex 3.7.10b International Relations Office Department _ Epoka University.pdf; Annex 3.7.10 Summary Table of BA BUS agreements and exchanges 2019_12_20_Bachelor BUS_IRO]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar në DVV si dhe nga informacioni i siguruar nga takimi me studentët, GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të posaçme për provimin final, ose Projektin e diplomës, e sanksionuar në rregulloren e programit. Institucioni e bën atë publike në guidën e studentit dhe në faqen e internetit [http://bus.epoka.edu.al/home-graduation-for-bachelor-279-2147.html; Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Institucioni dhe stafi akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>[Annex 3.8.1 STUDENT GUIDE FOR FINAL COMPREHENSIVE EXAM Business Administration Department _ Epoka University; Annex 3.8.1c Thesis-Writing-Guide]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të institucionit si dhe nga dokumentacioni i arshivuar rezulton, se provimi final mbështetet në vlerësimin e njohurive përfaqësuese të lëndëve të tre viteve akademike. Për hartimin e bankës së pyetjeve stafi akademik, mbështetet tek udhëzuesi i provimit final.</p> <p>[Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Referuar takimit me studentët e programit të studimit të vitit të tretë, si dhe me stafin e programit, rezulton se supervizorët akademikë që udhëheqin studentët në diplomë, orientojnë, udhëzojnë, kontrollojnë studentët gjatë punës përgatitore për projektin e diplomës. Para diplomimit teza e tyre, i nënshtrohet kontrollit të plagjiaturës nëpërmjet programit Turnitin.</p>

	<p>Institucioni ka vendosur në dispozicion edhe listën e supervisorëve të projektit të diplomës.</p> <p>[Annex 3.8.4b BUS Department Supervisors for the Final Comprehensive Exam and Graduation Projects 2015-2020]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ është e mendimit se fusha manaxheriale për realizimin e temave të diplomës, kërkon hulumtime empirike në terren dhe jashtë ambienteve të Universitetit Epoka, por institucioni, ka kapacitete për ti asistuar studentët në përpunimet statistikore kompjuterike që mund të realizojnë. Në funksion të suportit ndaj studentit, për të përgatitur tezën e diplomës, është edhe lënda me zgjedhje, “Metodat e hulumtimit në shkencat sociale” në semestrin e katërt.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar nga takimi me stafin akademik dhe nga DVV, stafi akademik ka të planifikuar disa seanca, për të asistuar studentët, për strukturën e punimit, metodologjinë, instrumentët e përdorur, përpunimin e tyre, si dhe mënyrën e shkrimit. Procedura e ndjekur është e sanksionuar në kumentin “Directive Graduation work of undergraduate programs” dhe në Thesis-Writing-Guide [Annex 3.8.1c]</p> <p>Rezulton se supervizori i temës, para paraqitjes së punimit para komisionit të diplomës, duhet të nënshkruajë lejen për paraqitjen e punimit në komision, nëpërmjet të cilës certifikon se punimi plotëson kushtet. [Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar ose projekti i diplomës, ka 7 ECTS dhe në përfundim studenti rezulton të vlerësohet me notë.</p> <p>[Annex 2.3 Program Curriculum.pdf; Annex 3.8.7 Graduation Thesis Evaluation Form]</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar DVV dhe evidencave përkatëse të cituara në vijim, rezulton se në përfundim të ps Bch. në AB, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASR.</p> <p>[Annex 3.8.8 Diploma Format BA BUS.;</p> <p>Annex 3.8.85b BUS-BA-suplement-diplome (3 years, 18.12.2013)]</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ mbështetur në informacionin e siguruar nga vizita në sekretarinë mësimore, rezulton se në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion, kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan</p>	<p>Pas mbarimit të studimeve dhe pajisjes me diplomë,</p>

për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	dokumentacioni i studentëve, rezulton të ruhet në Zyrën e Regjistrimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	<p>Të dhënat e personelit mbledhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo Zyrë është përgjegjëse për të mbledhur dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat në lidhje me rekrutimin e stafit të ri akademik, ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ, si dhe për të përditësuar dokumentacionin e stafit ekzistues, për të ndjekur procedurat ligjore për marrëdhënien kontraktuale të tyre me institucionin. Mbledhja e të dhënave bëhet mbi bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet në dy mënyra:</p> <p>me një dosje personale fizike;</p> <p>me një dosje elektronike në Sistemin Interaktiv Epoka, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore;</p> <p>GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejti se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të</p>

	<p>institucionit.</p> <p>[Annex 4.1 Full-time Staff Info Form_Template; Annex 4.2 Part-time Staff Info Form_Template; http://eis.epoka.edu.al/]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Statutin e Universitetit dhe që ndiqen në mënyrë rigoroz nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentet. IAL ka miratuar dhe zbaton një rregullore për rekrutimin e stafit, e cila ka për qëllim të përcaktojë kushte që duhet të plotësohen në rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Punës në RSH.</p> <p>[Annex 4.4 Statute_Uni_EPOKA_en.pdf neni 68 dhe neni 76; Annex 4.3 Regulation_Staff_Recruitment]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe specifike. Kriteret specifike vendosen nga Njësia bazë, që është Departamenti i Administrim Biznesit. Disa nga kriteret që përmban forma e aplikimit janë fusha e studimit, ciklet e studimit, eksperiencë në mësimdhënie, publikimet, pjesëmarrja në projekte etj. Ekziston një pikëzim për secilin kriter: për çdo pozicion ka një numër minimal pikësh të kërkuara. Të gjitha pozicionet e hapura publikohen në web faqen e Universitetit.</p> <p>[Annex 4.5 Academic Staff Application Form; Annex 4.6 Academic Staff Recruitment Form; Annex 4.7 Administrative Staff Application Form; Annex 4.8 Administrative Staff Recruitment Form]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësues dhe administrativ. ZBNJ drejton të gjithë procesin. Nevojat për vende të reja hapen me vendim të Bordit të Administrimit. ZBNJ e fillon procesin pasi merr kërkesën nga Njësia bazë. Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL ose në faqe të agjencive ndërkombëtare. Aplikimet bëhen online dhe përzgjedhja bëhet nga një juri. Për stafin akademik parashikohet dhe një leksion i hapur, në të cilin marrin pjesë antarët e jurisë. Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL dhe takimin e stafin akademik, ZBNJ GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> <p>[Annex 4.5 Academic Staff Application Form; Annex 4.6</p>

	Academic Staff Recruitment Form; Annex 4.7 Administrative Staff Application Form; Annex 4.8 Administrative Staff Recruitment Form; http://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html ; https://www.akadeus.com/ ; https://www.jobs.ac.uk/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që infrastruktura e UE krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli akademik ka zyra të veçanta dhe po ashtu edhe zyra mbledhjesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, salla interneti, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka, Sekretaria mësimore, etj. janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre. [RVBP_BA BUS_Tabelat permbljedhese_shqip.pdf, tabela 16]
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Universiteti EPOKA ka organizuar vazhdimisht trajnime për personelin akademik me synimin që të rrit zhvillimin profesional të tyre. Për një planifikim më të mirë IAL ka bërë një vlerësim të nevojave për trajnim dhe mbi këtë bazë ka përcaktuar tematikën e trajnimit. Disa nga trajnimet e zhvilluara janë mbi metodat e mësimdhënies, trajnim për metodat e kërkimit dhe seminare për hartimin e syllabuseve. Personeli akademik është inkurajuar gjithashtu të marrë pjesë në programet Erasmus+ ku kanë shkëmbyer përvoja dhe janë njohur me politikat e menaxhimit dhe zhvillimit në institucionet e arsimit të lartë në Evropë. GVJ nga vizita në institucion dhe dokumentacioni shtesë konstatoi që IAL ka organizuar sistematikisht trajnime me

	<p>personelin duke adresuar nevojat e tyre.</p> <p>[1-Request for the suggestions on the staff on topic for the next academic training - Internal Quality Assurance Unit; 2-evidence on the date of the email sent to staff for provision of suggested topics; 3-Topics Suggested by staff through google form; <u>1-Decision of the Rectorate on the Workshop Proposal of the NJSBC</u>; <u>2-News on the Announcement of the WORKSHOP ON COURSE DESIGN AND SYLLABUS DEVELOPMENT.pdf</u>; <u>Shenimet gjate vizites</u>]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, por edhe nga takimi me stafin e NJSBC GVJ konfirmoi që institucioni <i>ka organizuar programe specifike për të kualifikuar më tej stafin e tij</i>. Në shtator 2019 institucioni ka zhvilluar një trajnim me ekspertë të huaj për përdorimin e metodave digjitale në arsimin e lartë. Trajnimi është zhvilluar në dy ditë dhe kanë marr pjesë 55 pjesëmarrës.</p> <p>Rezultatet që priteshin nga ky trajnim kanë qënë njohja me metodat e ndryshme digjitale në mësimdhënie dhe përdorimi praktik i këtyre teknologjive. GVJ konstatoi gjatë takimeve në institucion që njohuritë e marra kishin ndihmuar stafin për të realizuar mësimdhënien online gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p>[4-Decision on the Training.PDF; 5-Final_training_Agenda; 8-Attendance List of Participants- 2019 09 26; 12-Report_of_the_Training_on_Digital_Education; 10-Survey Results about the training on digital education 07-10-2019-converted; <u>Shënimet gjatë vizitës</u>]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesit planifikon kohën vjetore të punës sipas nevojave për realizimin e procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve. Sipas evidencave të dorëzuara për ngarkesën totale të personelit akademik për këtë program studimi për vitin 2019-2020, GVJ konstatoi që janë angazhuar 32 personel akademik, nga të cilët 11 janë PAK.</p> <p>PAE i angazhuar në këtë PS mbulon orë mësimore në auditor që variojnë nga minimum 192 orë mësimore në maksimumin 640 orë mësimore.</p> <p><i>GVJ gjykon që për një pjesë të PAE ngarkesa është e lartë dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e mësimdhënies.</i></p> <p>[RVBP_BA BUS_Tabelat permbledhese_shqip, tabela 4]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>IAL e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe modulet përkatëse. Godina ku gjendet Fakulteti Ekonomik dhe zhvillon mësimdhënien e PS, Departamenti i Administrim Biznesit ka hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve (134 në të tre vitet) që ka aktualisht. Sipërfaqja m²/për student është 7.4, ndërkohë që për personelin është 20.08.</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme.</p> <p>[RVBP_BA_BUS_Tabelat permbledhese_shqip, tabela 16; Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konfirmoi në vizitën e tij në institucion që auditorët ishin të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme (tabela, videoprojektor dhe PC) për një proces efektiv mësimor në përputhje me qëllimet e programit.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave</p>	<p>Për aktivitetet e programit janë gjithashtu në dispozicion katër laboratorë kompjuterikë të pajisur plotësisht dhe dy laboratorë elektronikë. Për të mundësuar një proces efektiv të mësimdhënies dhe mbështetur studentët në veprimtarinë mësimore dhe kërkimore, janë instaluar programe kompjuterike si: Windows: MS Office, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 fundit, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL \ Workbench, Eclipse,</p>

formues të programit të studimit në tërësi.	Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + -MAX, SPSS, EViews , etj. Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit përditëson programet në laboratorët e kompjuterave çdo semestër, bazuar në kërkesat e personelit akademik.			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	GVJ gjatë vizitës në institucionin konfirmoi që IAL ka katër laboratorë të pajisur mirë të teknologjisë së informacionit të cilat janë të pajisura me programet të nevojshme për të realizuar një proces mësimdhënie efektiv. Laboratorët mund të përdoren nga studentët për të përgatitur detyrat dhe punimet e tyre të diplomës.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Në lidhje me këtë kriter, referuar dokumentacionit por edhe vizitës në institucion, GVJ shprehet se ky kriter do të aplikohet për programin në fjalë në vitin akademik 2020-2021. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe administrative ka 36 marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale me një numër të madh kompanish, që zhvillojnë aktivitetin e tyre në fusha të ndryshme, çka do ta lehtësojë realizimin e praktikës profesionale për studentët e këtij PS. [RVBP_BA BUS_Tabelat permbledhese_shqip, tabela 5]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni disponon një bibliotekë, me sipërfaqe 400m ² dhe kapacitet 100 vende. Këto mjedise mund të shfrytëzohen nga studentët e këtij programi studimi. GVJ vizitoi bibliotekën dhe konfirmoi që ambjenti ishte i hapur me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët. Fondi i librave është i hapur dhe mund të konsultohet lirshëm nga studentët. Studentët kanë të drejtë të huazojnë libra dhe t'i mbajnë ato deri në 15 ditë dhe maksimumi i tekseve që mund të marrin

	<p>njëkohësisht është 3.</p> <p>[45.1 Library Annex (1) ; http://library.epoka.edu.al/cat-regulations-484.html]</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar evidencave biblioteka ka një fond prej 25000 libra dhe 2000 revista akademike dixhitale. Literatura është bashkëkohore dhe një pjesë e konsiderueshme reflektohet në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Institucioni siguron një numër të konsiderueshëm të teksteve mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse. Numri i titujve në fushën e ekonomisë në bibliotekën e UE është 746, ndërsa numri i kopjeve rreth 3700. Fondi i librave mund të konsultohet gjithashtu online. Bazuar në kërkesat e personelit akademik fondi është zgjeruar për çdo vit akademik dhe është vendosur në shërbim të studentëve.</p> <p>[45.1 Library Annex (1); 45. List of Books BUS; Request for books 2017-2018; Request for books 2019-2020; http://lib.epoka.edu.al/]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi që UE ka anëtarësim të plotë në JSTOR. Çdo anëtar i personelit akademik ka akses në koleksionet e JSTOR dhe mund të shkarkojnë disa artikuj në mënyrë periodike.</p> <p>Studentët mund të kërkojnë libra në http://lib.epoka.edu.al/ ose mund të kenë akses në koleksionet e JSTOR duke shkuar në http://www.jstor.org/</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Aktualisht biblioteka ka pajisje elektronike dhe akses në internet, e cila iu mundëson studentëve shfrytëzimin e fondeve të bibliotekës online. Fondi i bibliotekës është i gjithi digjitalizuar dhe studentët mund ta konsultojnë atë online. [http://lib.epoka.edu.al/]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që UE ka shtuar fondin e librave në fushën e biznesit me 24 tituj të rinj në periudhën 2017-2020. Kërkesa është bërë nga personeli akademik i departamentit të Administrim Biznesit. Fondet e librave mund të shtohen edhe përmes donacioneve, por IAL nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë për ta verifikuar këtë procedurë.</p> <p><i>GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e mirë dhe duhet të vazhdojë, pasi mundëson jo vetëm pasurimin e fondeve por dhe përditësimin e literaturës.</i></p> <p>[Request for books 2017-2018; Request for books 2019-</p>

	2020]			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që orari i bibliotekës është çdo ditë të javës 08:30 – 12:30/13:30 - 17:30 dhe ditën e Shtunë 9:00-13:00. Oraret e shërbimit janë të përshtatshme për studentët e këtij programi studimi. Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, në pushimet midis orëve ose kur punonin për kryerjen e detyrave në grup dhe duhet të rishikonin literaturë. [http://library.epoka.edu.al/home.html]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas dokumentacionit institucioni përdor një sistem të brendshëm për të menaxhuar të gjitha informacionet. Sistemi Interaktiv Epoka (EIS) është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Çdo student pajisjet me email-in e tij dhe mund të regjistrohet në llogarinë personale të studentit në EIS. Ndërfaja e studentëve jep të gjitha detajet në lidhje me kurset e marra nga studentët, notat, frekuentimin, financat, informacione brenda kampusit, informacione personale të studentëve. Sistemi ofron informacione për vitin aktual akademik. [Annex No. 2.2 - EIS GuideLine - Students-Draft]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve	EIS i siguron personelit akademik disa funksionalitete për të ndjekur dhe menaxhuar rezultatet akademike të studentëve, frekuentimin dhe gjithashtu disa funksione të përgjithshme që i përkasin statusit të stafit. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që EIS menaxhon të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet e personelit akademik dhe administrativ në mënyrë hierarkike. Ai është një sistem funksional dhe një instrument efektiv për menaxhimin e

të angazhuar në realizimin e programit.	informacionit dhe dokumentacionit. [Annex No. 2.1 - EIS GuideLine - Lecturer-Draft]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	EIS siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin informatik EIS. [Annex No. 2.2 - EIS GuideLine - Students-Draft; Annex No. 2.1 - EIS GuideLine - Lecturer-Draft]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	UE ka dhe një sistem të menaxhimit të mësimdhënies (LMS) e cila lehtëson komunikimin interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogeve dhe studenteve në kohe reale. Sistemi bazohet në Moodle, mundëson aksesin, koordinimin dhe organizimin e lëndëve në internet. Studentët dhe instruktorët mund të identifikohen në LMS duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit dhe përmes platformës mund të kenë komunikime interaktive. Studentët dhe lektorët përdorin gjithashtu Google Classroom në kuadër të platformës Google Suite që aksesohet nga personeli dhe nga studentët me anë të emaileve zyrtare të institucionit. [http://lms.epoka.edu.al/course/index.php?categoryid=388]
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit EIS siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuar sipas roleve dhe njësive përkatëse. Staf i akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. EIS u siguron atyre informacione të azhuruara dhe i ndihmon ata të marrin vendime të informuara bazuar mbi të dhëna.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja e internetit të UE paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentët në anglisht. Departamenti ka dhe faqen e vet, ku jep informacion më të dedikuar për studentët e PS. Gjatë vizitës në IAL GVJ konstatoi që departamenti po punon për të vendosur të gjithë informacionin në gjuhën shqipe në faqen e tij. [http://www.epoka.edu.al/ ; http://bus.epoka.edu.al/]
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet


standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton një Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar për UE. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative harton në veçanti një plan buxhet me zërat respektiv për mbulimin e të gjithë programeve të studimit. Departamenti ka një buxhet specifik për programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznes". Sipas raportit vjetor të institucionit kostoja mesatare për një student është 1793 Euro.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019;1.13Annual_Report_2018-2019_academic_year_BUS_department, fq.28-31]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas raportit vjetor departamenti dhe Fakulteti përcjell projekt buxhetin për të gjitha programet e studimit, i cili përmban shpenzimet për paga, shpenzime të tjera operative dhe investimet. Bordi Administrativ aprovon buxhetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit bazuar në nevojat e Njësive bazë dhe Njësisë kryesore, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifat e studentëve. Fondet e tjera përfshijnë financimet e projekte kërkimore ndërkombëtare dhe fonde të tjera kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare. Pas miratimit të buxhetit nga Bordi Administrativ, Zyra e Financave në bashkëpunim me Administratorin ndjek shpërndarjen dhe zbatimin e buxhetit.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar</p>	<p>Universiteti Epoka funksionon si institucion brenda kompanisë "Turgut Ozal Education" sh.a dhe auditimi vjetor i jashtëm në lidhje me situatën financiare kryhet nga kompania si një i tërë. Raporti i auditit gjendet pranë</p>

<p>përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a.. Raporti përmban analizën e të dhënave për shpenzimet dhe të ardhurat e kompanisë dhe institucioneve të përfshira në të, të gjitha hyrjet që lidhen me të ardhurat (grante, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ai ofron drejtpërdrejt ose indirekt (duke iu dhënë shërbime të jashtme kompanive). Një kopje e raportit të auditimit vjetor gjendet në Zyrën e Financave të Universitetit Epoka.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion GVJ konfirmon që raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. Të dhënat dhe analizat i komunikohen Universitetit Epoka, një kopje e tij gjendet në Zyrën e Financave dhe një tjetër në Zyrën e Administratorit.</p> <p>GVJ konstatoi që në raportet vjetore, UE ka një pjesë të raportit financiar për vitin korent dhe paraardhes ku edhe paraqitet një analizë e përgjithshme mbi të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2016-2017</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Sipas raporteve vjetore të institucionit të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet për tre vitet e fundit. GVJ konstatoi bilanc pozitivë për të gjithë periudhën, e cila garanton qëndrueshmërinë financiare të IAL. Tendenca e të ardhurave nga tarifat e studentëve është në rritje për të gjithë periudhën, ndërkohë që shpenzimet janë rritur më pak se të ardhurat.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2016-2017</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UE ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht për pranimet në këtë cikël studimi, të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit të publikuar në anglisht nga UE. [http://admissions.epoka.edu.al/ ; http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation ; 1.2_statute-of-epoka-university]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UE nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Specifikisht të drejtat e studentëve paraqiten në kreun VI të Rregullores në fjalë dhe nenin 117 të statutit. [http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation]; pjesa VI; 1.2_statute-of-epoka-university, neni 117]
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit. Të gjitha informacionet e referuara për pranimin, procedurat dhe dokumentat e regjistrimit, tarifën, bursat dhe transferimin e studimeve janë të publikuara në faqen e internetit të Zyrës së Pranimit të Universitetit EPOKA.

	<p>Informacioni publikohet gjithashtu dhe në rrjetet sociale në faqen e universitetit.</p> <p>[http://admissions.epoka.edu.al/cat-bachelor-admissions-1923.html]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>UE ka përcaktuar dy kritere të veçanta për pranimin në ciklin e parë në PS që ofrohet në anglisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët duhet të zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme ose ekuivalente me të, me mesatare minimale të shkollës së mesme 7.00; • Niveli i aftësive në gjuhën angleze B1 në një nga provimet e njohura ndërkombëtarisht; <p>Për programet e studimit që ofrohen në gjuhën shqipe mesatarja është përcaktuar 6.5. GVJ konfirmon që kriteret janë hartuar përpara fillimit të vitit akademik dhe janë publikuar në faqen e Zyrës së Pranimit.</p> <p>[http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html]</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion konfirmon që kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve janë hartuar në përputhje me aktet nënligjore të MASR. Institucioni pranon në të gjitha programet e tij Bachelor, studentë ndërkombëtarë që plotësojnë kriteret e pranimit dhe ndjekin procedurën e regjistrimit, por ky është një numër i kufizuar studentësh, bazuar në kuotat e pranimit për studentë të huaj të aprovuar nga MASR. Pranimi në këtë cikël studimesh realizohet përmes portalit U-Albania.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL u informua që Zyra e Pranimit organizon ditët e informimit për maturanët e shkollave të mesme. Maturanët ftohen në kampus dhe marrin informacion të detajuar për universitetin dhe për programe specifike studimi. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar. Maturanëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet. Kriteret dhe kërkesat publikohen në faqen e internetit të Zyrës së Pranimit. Informacioni i detajuar mbi kurrikulat e programeve të studimit dhe kurrikulën e Bsc në Administrim Biznesi janë botuar gjithashtu faqen e internetit.</p> <p>[http://eis.epoka.edu.al/curricula; http://eis.epoka.edu.al/curricula/21/program; Shënimet gjatë vizitës]</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbush et	Përmbushet pjesërisht	Përmbush et kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit. Në nenin 46 të saj ofrohet informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Sistemi i menaxhimit të informacionit (ESI) dhe aksesit që studentit ka në të i jep çdo informacion lidhur me këto procedura. GVJ e konstatoi këtë edhe nga pohimet gjatë takimit me studentët.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UE mundëson transferimet brenda universitetit dhe midis universiteteve. Neni 41 i Rregullores Themelore dhe Direktiva “Për transferimin e studentëve” përcakton procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet për njohjen e studimeve të plota ose të pjesshme të studentëve. Këto procedura mund të aksesohen nga studentët në faqen e institucionit. Aplikimet paraqiten në Zyrën e Regjistrimit shqyrtohen nga departamenti dhe i përcillen Dekanatit të Fakultetit për miratim përfundimtar. Dekanati i Fakultetit analizon kërkesën dhe nëse njohuritë që studenti ka fituar në atë lëndë konsiderohen të mjaftueshme, studenti mund të lirohet nga detyrimi për të marrë pjesë në kurs. Në këtë rast, Dekanati i Fakultetit vendos se në cilat lëndë kërkohet të marrë pjesë studenti.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation]; http://epoka.edu.al/mat/directives/13]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren bazë, kreu VII dhe VIII. Po ashtu në syllabusin e çdo lënde, që gjendet në sistemin EIS studentët njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në çdo lëndë.</p>

	<p>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Studentëve iu jepet gjithashtu një udhëzues praktik me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit (kohëzgjatja e rregullt e studimeve, organizimi i programit, pjesëmarrja në klasë dhe vlerësimi).</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation; http://eis.epoka.edu.al/curricula/13188/1/syllabus]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e UE dhe në direktivën për diplomimin. Për të mbështetur studentët, institucioni ka përgatitur një udhëzues specifik mbi procesin e punimit të diplomës dhe një udhëzues për provimin përfundimtar.</p> <p>[Annex 3.8.1c Thesis-Writing-Guide; Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs; Annex 3.8.1 STUDENT GUIDE FOR FINAL COMPREHENSIVE EXAM Business Administration Department _ Epoka University]</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Pranimit organizon në mënyrë periodike ditë të hapura ku ftohen studentët potencial në kampus për të marrë informacion të detajuar për universitetin dhe programin specifik të studimit. Pas marrjes së informacionit të përgjithshëm nga Zyra e Pranimit, studentët shoqërohen për të marrë informacion më të detajuar mbi programet e veçanta të studimit nga stafi akademik. Institucioni ka përgatitur dhe një guidë orientuese që informon studentët për programin e studimit.</p> <p>[Annex 3.6.7 Smart_Student_Guide_2019-2020]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe

<p>informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë dhe komunikimit me Zyrën e Pranimeve. Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës të orientimit kryesisht nga përgjegjësi i Departamentit, i cili është dhe koordinator i programit. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen e institucionit. Institucioni ka përgatitur dhe një guidë orientuese që informon studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.</p> <p>[36. Program Coordinator; Annex 3.6.8 Orientation Week Programs; Annex 3.6.7 Smart_Student_Guide_2019-2020]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit (EIS) studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me lëndët, rregjistrimet, orarin dhe notat. Në faqen e internetit të UE publikohet orari mësimor dhe i provimeve (timetables), dhe materiale mësimore mbi lëndë të ndryshme (përmes sistemit LMS). GVJ nga konstatimi i sistemit të menaxhimit konfirmoi se informacioni i përcillej studentëve online.</p> <p>[http://epoka.edu.al/home-students-timetables-4-395.html]; http://lms.epoka.edu.al/]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni (CPAO) u informua që kjo zyrë orienton studentët drejt tregut të punës. Çdo student që merr pjesë në aktivitete të zhvillimit të karrierës duhet të regjistrohet pranë zyrës përkatëse duke ndjekur hapat e përshkruar në Rregulloren e Zyrës së Këshillimit dhe të Karrierës (Shtojca 5.1). Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni informon studentët për praktikën dhe mundësitë e punësimit. Panairi i Karrierës organizohet çdo vit për të prezantuar tek studentët mundësi të tilla. Departamenti i Administrim Biznesit ka vendosur marrëdhënie bilaterale me institucione dhe organizata të ndryshme që mund të mundësonin zhvillimin e praktikës për studentët</p> <p>[http://cpao.epoka.edu.al/home-sixth-career-fair-2019-1593-2658.html]; Annex 5.1 Consueling and career guidance office Regulation]</p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor afishohet në faqen e internetit (timetables) dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Përmes guidës orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre.</p> <p>[Annex 3.6.7 Smart_Student_Guide_2019-2020]</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Çdo pedagog ofron komunikimin nëpërmjet LMS (Sistemit të Menaxhimit të Mësimit) dhe e-mail-it me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë. Studentët mund të futem me email-in e tyre në sistem ku gjejnë të gjithë informacionin. Studentët mund të aksesojnë sistemin dhe nga jashtë institucionit, pasi platforma është webbased.</p> <p>[http://lms.epoka.edu.al/]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen regjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020 është 59 studentë ose rreth 96.6% më i lartë se në vitin akademik 2018-2019, dhe rreth 47.5% më i lartë se në vitin akademik 2016-2017. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar politika e bursave që ndjek ky institucion. Ndërkohë mesatarja në hyrje ka qënë mbi 8.6 në të tre vitet e fundit akademike. GVJ kontrolloi regjistrin themeltar të studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe regjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejtë gabime apo problematika.</p> <p>Sipas (RVBP_BA_BUS_Tabelat_permbledhese_shqip.pdf, tabela</p>

	<p>nr.21) dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2017-2018 39 studentë gjithsej;</p> <p>Viti 2018-2019 30 studentë gjithsej;</p> <p>Viti 2019-2020 65 studentë gjithsej;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon statistika për numrin e të regjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve etj. Numri i studentëve të regjistruar në PS për 3 vitet e fundit akademike është 134 nga të cilët vetëm 14 janë studentë të transferuar. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale. Një pjesë e të dhënave publikohen në raportin vjetor.</p> <p>[RVBP_BA BUS_Tabelat permbledhese_shqip, tabela 21; http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi që sekretaria regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni hidhet online dhe është i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Sekretaria mësimore nëpërmjet sistemit elektronik që disponon mund të printojë listën e notave për studentët e vet. Sistemi llogarit mesataren për çdo semestër dhe mesataren e përgjithshme e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi performancën e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kanë akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësisive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi asnjë mangësi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të cilin e përfshin në Raportin Vjetor. Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar ka krijuar bazën e të dhënave të studentëve të diplomuar dhe zhvillon çdo vit një anketë, rezultatet e së cilës i dërgohen departamentit dhe publikohen në faqen zyrtare.</p>

masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	[http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Statuti i UE parashikon përfshirjen e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik; Bordin e Etikës; Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; dhe Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore.</p> <p>[1.2_statute-of-epoka-university.pdf nenet 15/4, 29/2, 34/2, 35/8]</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Sipas statutit studentët janë pjesë e vendimmarrjes në Senatin Akademik, Bordin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë .</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që IAL është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre. Gjatë vizitës GVJ konfirmoi gjithashtu se Këshilli Studentor funksionon dhe antarët e tij përçojnë shqetësimet e studentëve në të gjitha trupat vendimmarrëse. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë; është një proces i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe është një instrument që ka ndihmuar në përmirësimin e programeve dhe adresimin më të mirë të nevojave të studentëve.</p> <p>[1.2_statute-of-epoka-university; 37. BA in BUS Course Instruction Survey Results; Student Satisfaction Survey]</p>

<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe duke zbatuar aktet ligjore në fuqi. Statuti dhe rregullorja parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme, mobilitetet e studentëve dhe ripranimin në programin e studimit.</p> <p>[1.2_statute-of-epoka-university; Annex 3.5.1 Regulation On Undergraduate Studies and Examinations; http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben pyetëtori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. Ky pyetësor menaxhohet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe analiza e rezultateve i shkon Rektorit, i cili duke e përcjellë në Departament, urdhëron të përpilohet plani i masave përkatëse. GVJ konstatoi këtë proces nëpërmjet dokumentacionit të disponuar dhe takimit me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja mbi studimet universitare dhe provimet, si dhe udhëzimi mbi provimet mundëson barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit, rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të provimit studentëve si dhe përcakton përcaktimit e procedurës që duhet të ndiqet nga institucioni në çdo rast. GVJ konstatoi se ky informacion ju bëhej me dije studentëve dhe u konfirmua po ashtu edhe gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë.</p> <p>[Annex 3.5.1 Regulation On Undergraduate Studies and Examinations; Annex 3.6.3 Guideline “On Examinations”; Shënimet e takimit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë

permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>UE ka krijuar strukturën e zyrës së Dekanit të Studentëve, e cila u siguron studentëve mbështetjen, burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Dekani i studentëve pranon kërkesat e tyre çdo ditë dhe kërkesat vlerësohen nga strukturat përkatëse. Zyra e dekanit të studentëve informon me e-mail studentët për vendimin në lidhje me kërkesën e tyre.</p> <p>[1.2_statute-of-epoka-university; http://dos.epoka.edu.al/cat-about-us-549.html]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, siç janë Zyra e Regjistrimit, Koordinatori i programit, Zyra e Pranimeve, Zyra e Koordinimit të Studentëve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni. Rregulloret e institucionit parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies në mënyrë që ata të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Drejtoritë në shërbim të studentit organizojnë aktivitete si ditët e orientimit, panairët e punës, dhe fushatat e informimit për të promovuar shërbimet e tyre. Zyra e Regjistrimit pajis studentët me Udhëzuesin e Studentit që përmban informacione të hollësishme për jetën e studentit, nga regjistrimi deri në diplomim</p> <p>[Annex 2.4 Smart_Student_Guide_2019-2020]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të diplomuar GVI u informua që zyra ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p> <p>[Annex 3.7.5d Website of Career Planning and Alumni Office Department _ Epoka University; Shënimet e takimeve]</p>

punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të diplomuar ka si detyrë gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo disponon një bazë të dhënash mbi studentët e diplomuar në këtë institucion. GVJ konfirmon që zyra zhvillon çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar dhe rezultatet i vihen në dispozicion departamenteve dhe publikohen në faqen zyrtare të Zyrës. [http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UE ka krijuar struktura dhe miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit. Statuti parashikon ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional në neni 14 të tij , ndërsa neni 35 përcakton detyrat e komisionit, dhe nenet 37-38 strukturën dhe kompetencat e Zyrës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, IAL ka miratuar Politikën e Cilësisë që mbulon politikat në lidhje me parimet dhe standardet kryesore të sistemit të menaxhimit të cilësisë. I gjithë informacioni në lidhje me strukturat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është publikuar në faqen e IAL. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që UE ka ngritur struktura dhe miratuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të

	<p>Cilësisë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë në RSH" dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>[Annex 1.2_statute-of-epoka-university; Annex EPOKA_Quality Assurance Handbook_19_12_2018_final; Annex 6.1-Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised; Aneks 6.7-Quality Policy; http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin Njësinë, Komisionin, rregulloret, procedurat, udhëzimet dhe instrumentat e sigurimit të cilësisë. Në bazë të statutit, institucioni e ka ngritur sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili monitorohet nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Komisionit të Përhershëm në nivel Institucioni dhe auditit të brendshëm. Në NJSBC përfshihet personel administrativ i cili ndjek procedurat për sigurimin e cilësisë dhe ka karakter kryesisht administrativ dhe procedural. Stafit miratohet me propozim të Rektorit nga Senati Akademik. Roli i Njësisë (Zyrës) përfshin vlerësimin periodikë të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në njësitë kryesore të Universitetit, kryen studime eksploruese për të vlerësuar punësimin e studentëve dhe efektivitetin e programeve të ofruara nga Universiteti, si dhe organizon pyetësorin e studentëve për cilësinë e lëndëve mësimore për secilin program studimi. Njësia varet dhe raporton në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Komisioni përbëhet nga 12 antarë, nga të cilët një është student dhe një ekspert i jashtëm. GVJ konstaton se sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur dhe funksion në mënyrë të efektshme.</p> <p>[Annex 1.2_statute-of-epoka-university.pdf; Aneks 6.1-Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised.pdf; Annex 6.7-Quality Policy.pdf; http://aeqi.epoka.edu.al/cat-permanent-commission-on-quality-assurance-1408.html]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të</p>	<p>NJSBC përdor disa instrumenta për vlerësimin periodik të mësimdhënies, mësimnxënies, veprimtarive kërkimore dhe shërbimeve për mbështetjen e studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - formulari i vlerësimit të instruktorit / kursit; - pyetësori me alumni; - formulari i vlerësimit të mësimit; - anketa e kënaqësisë së studentëve;


<p>tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>- vlerësimi i publikimeve shkencore dhe veprimtarive akademik;</p> <p>Të dhënat grumbullohen, përpunohen nga NJSBC dhe bëhen pjesë e raportit vjetor të institucionit. IAL i është nënshtruar vlerësimit institucional tre herë dhe ka marr vlerësim pozitiv. Gjithashtu të gjitha programet e studimit i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm. PS Bsc në Administrim Biznes është akredituar dy herë. Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm janë të publikuara në faqen e institucionit. GVJ konstatoi që IAL përdor instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë dhe ky proces realizohet me përfshirjen e të gjitha strukturave.</p> <p>[http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html</p> <p>http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Universiteti Epoka ka si objektiv promovimin e cilësisë në nivel institucional, në njësitë përbërëse dhe tek të gjithë aktorët e brendshëm institucional. Këtij objektiv i shërben dhe politika e cilësisë dhe politika për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore. Krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programve IAL vlerëson çdo vit performancën e programeve të studimit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, rishikon dhe përmirëson ato duke marr në konsideratë nevojat e tregut të punës, opinionet e marra nga studentën dhe alumni, vlerëson mësimdhënien dhe rezultatet e të nxënit. GVJ gjykon se të gjitha përpjekjet e institucionit dhe instrumentat e ndryshëm që përdor i shërbejnë krijimit të kulturës së cilësisë në rang institucional. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë, për të krijuar këtë kulturë dhe për të bërë procesin transparent.</p> <p>[Annex 6.3-Policy on Continuous Improvement of Study Program; Annex 6.7-Quality Policy]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave

formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Bazuar në statutin e IAL, Departamenti është përgjegjës për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia bazë monitoron dhe rishikon programet e studimit, mbështetur në Politikën për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit. Propozimet e departamentit për përmirësimin e kurrikulës diskutohen fillimisht në Dekanat. Propozimi i miratuar nga Dekanati për përmirësimin e programit të studimit i dërgohet Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave, dhe më pas propozimi dërgohet në Komisionin e Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë. Senati Akademik merr vendimin përfundimtar në lidhje me përmirësimin e programit të studimit mbështetur në rekomandimet e komisioneve. GVJ konstatoi që NJSBC dhe të dy komisionet bashkëpunojnë me Departamentin dhe Dekanatin për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> <p>[Annex 6.3-Policy on Continuous Improvement of Study Program; Annex 6.6-Curriculum Change Proposal Form; Curriculum Change Proposal Form BA BUS]</p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Departamenti i Administrim Biznesit, si njësi bazë e menaxhimit të programit të studimit propozon ndryshimet në kurrikulën e programit. Rishikimet e programit të studimit janë kryer në bazë të kërkesave ligjore kryesisht, por edhe duke vërejtur nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve. Sipas Evidencave, për programin në fjalë janë kryer përshtatjet sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, janë përfshirë disiplina të reja, është ndryshuar kategorizimi i disa disiplinave, por nuk ka patur ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve. Ndryshim tjetër është futja e praktikës profesionale si lëndë e detyruar. Të gjitha ndryshimet janë përcjellë me procedurë të veçantë në Rektorat dhe Senat. Të gjitha hallkat e ndjekura në këtë proces janë të dokumentuara dhe formalizuara.</p> <p>[Annex 6.3-Policy on Continuous Improvement of Study Program; Annex 6.6-Curriculum Change Proposal Form; Curriculum Change Proposal Form BA BUS; Curriculum Changes Table- BA BUS; Curriculum Changes Table_BA BUS 14-02-2020; Professional Practice Proposal_2020-2021]</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe	Metodologjia e vlerësimit të PS është përcaktuar tek Politikat për Përmirësimin e Vazhdueshëm të PS. Disa nga



vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

instrumentat që IAL përdor për të matur ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve janë:

- Pyetësorët me studentët, që plotësohen në fund të çdo semestri. Studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe brendinë e lëndës. Rezultatet e marra nga vlerësimet e studentëve janë një element i rëndësishëm për të vlerësuar progresin e PS;
- Pyetësori me studentët për kënaqësinë e shërbimeve;
- Raporti i departamentit për rezultatet përfundimtare të studentëve për të gjitha lëndët;
- Raporti mbi cilësinë e provimeve dhe korigjimeve përgatitur nga Bordi i Provimeve. Raporti iu shpërndahet të gjitha njësive përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve të ngritura;
- Raporti Vjetor i cili përfshin informacione dhe analiza mbi treguesit kryesorë të performancës së programeve të studimit, siç është niveli i diplomimit të studentëve, shkalla e kalimit të studentëve për të matur rezultatet e të nxënit;
- Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe planet e veprimit për të ndjekur rekomandimet e mbetura nga akreditimi i mëparshëm;
- Vlerësimi i Performancës Akademike në Mësimdhënie, Kërkim dhe Projekte sipas Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë;
- Krijimi i bazës së të dhënave të vlerësimit të departamentit për secilin program studimi, i cili përfshin informacionin e treguesve kryesorë të performancës për secilin program studimi dhe ia dërgon Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë;

[Annex 6.2-Directive_Acad _ Admin Perfor Assess _ Quality Improv; Annex 6.4-Course Instructor Evaluation Survey; Annex 6.10-Exam Assessment Form; Annex 6.11- Examination Period Assessment Form; Shenimet gjate vizites; <http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html>; <http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html>]

Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe

Rezultatet e instrumentave monitorues dhe vlerësues përpunohen nga strukturat përgjegjëse dhe përmbledhen në formën e raporteve. Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe gjatë vizitave në IAL GVJ konstatoi që rezultatet e vlerësimeve

vendimmarrëse për programin e studimit.	dokumentohen dhe u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse dhe vendimmarrëse për PS. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të publikuara në faqen e IAL. [http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html]; http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html ; BA in BUS Course Instruction Survey Results; Outcomes of the Academic Staff Satisfaction Survey]			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatohet që në raportet vjetore përfshihen rezultatet e pritshme të vlerësimit dhe rezultatet e arritura. Ndërsa për ta adresuar mangësitë hartohen plane veprimi të veçanta ku pasqyrohen rekomandimet, masat që duhen marrë dhe progresi që është bërë. [Annex 6.16 -BUS Action Plan in Response to the Recommendations]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përcor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Departamenti i Administrimit Biznesit, i cili është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, ka kryer tre vlerësime të brendshme për këtë program studimi (ky raport është i treti). Në të gjithë këtë proces departamenti është mbështetur nga NJSBC. Rezultatet e mëparshme të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm janë përfshirë në planin e masave për zbatim e plotësim të rekomandimeve, ku ndër të tjera përfshihet masa e ndërmarrë dhe progresi i bërë. Departamenti realizon gjithashtu në mënyrë periodike analizë të punës mësimore dhe shkencore të stafit akademik që mbulon programin e studimit dhe publikon një raport vjetor. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatohet që vlerësimi i programit është kryer në mënyrë periodike dhe informacioni është përfshirë dhe në vetëvlerësimin institucional. [Annex 6.16 -BUS Action Plan in Response to the Recommendations; V.4.1. Annual_Report_2018-

	2019_academic_year_BUS_department]
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	<p>Për kryerjen e vlerësimit IAL përdor disa instrumenta si: pyetësori për kursin/instruktorin; pyetësori për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësori për kënaqësinë e studenëve me shërbimet, pyetësori me alumni, forma për vlerësimin periodik të provimeve, pyetësori për vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimi i publikimeve dhe aktivitetit akademik. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumentat e përdorur i përshtaten fushës akademike të programit të studimit dhe përdoren periodikisht nga IAL.</p> <p>[Annex 6.12-EPOKA_Quality Assurance Handbook_19 12 2018_final]</p>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>Për të realizuar vlerësimin e PS përdoren disa metoda të drejtëpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve. GVJ konstatoi që IAL përdor metoda të drejtëpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korrigjimit të provimeve, rishikimin e kurrikulës, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese.</p> <p>[Annex 6.7-Quality Policy; Annex 6.8-Directive “On the Functioning of the Exam Board“; Annex 6.11-Examination Period Assessment Form; Policy on Continuous Improvement of Study Program]</p>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që	<p>IAL përdor disa instrumenta të tërthortë për të vlerësuar cilësinë e PS si pyetësori për kursin/instruktorin; pyetësori për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësori për kënaqësinë e studenëve me shërbimet, pyetësori me alumni. Kështu vlerësimi i pedagogëve bëhet në fund të çdo semestri, nga llogaria personale e studentëve, përpara fillimit të provimeve. Departamenti përgatit raport mbështetur në rezultatet e anketimit. Anketimi ka pyetje në lidhje me përmbajtjen e lëndës, metodat e mësimdhënies, performancën e pedagogut të lëndës dhe stafit ndihmës, shërbimet e ofruara nga universiteti si dhe rekomandimet e studentëve. Rezultatet e të gjitha anketave përpunohen dhe i shërbejnë vlerësimit të mbarëvajtjes së PS. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe</p>

përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	takimet në IAL konstatoi që këto instrumenta përdoren periodikisht dhe i kanë shërbyer përmirësimit të PS. [BA in BUS Course Instruction Survey Results; Outcomes of the Academic Staff Satisfaction Survey; Alumni Survey.pdf; Student Satisfaction Survey; <u>Shënimet gjatë vizitës</u>]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen KPSC, NJSBC, Departamentet dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. KPSC përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore me të paktën gradën shkencore Doktor dhe i paangazhuar në detyra të nivelit të lartë, dy anëtarë të stafit administrativ, një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit, si dhe një specialist të jashtëm me përvojë në çështje të sigurimit të cilësisë. Këta janë zgjedhur nga Senati Akademik, për një periudhë dy vjeçare, me të drejtën për riemërimi. Aktualisht të gjithë antarët e NJSBC janë në mandatin e dytë. Nënkryetari i Këshillit Studentor për çështje të sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë dhe e ka filluar detyrën në Dhjetor 2019 [1.2_statute-of-epoka-university.pdf neni 15 dhe 35; <u>Shënimet gjatë vizites;</u> http://aeqi.epoka.edu.al/cat-permanent-commission-on-quality-assurance-1408.html]
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe	Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga IAL dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon që strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në aktet rregullatore specifikohen qartë mënyra e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, mandati i antarëve në komision, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato

<p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>ndërveprojnë. GVJ konstaton që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p>[1-Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised; 2. Main Unit (Article 11) and Base Unit (Article 12) Regulation, Statute_Uni_EPOKA_en]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion dhe gjatë vizitës në IAL, GVJ konfirmoi që në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bsc në “Administrim Biznes” janë përfshirë Fakulteti, Departamenti i Administrim Biznesit, antarët e personelit akademik përmes instrumentave të ndryshme të vlerësimit të brendshëm, NJSBC, alumni dhe studentët nëpërmjet pyetësorëve.</p> <p>[37. BA in BUS Course Instruction Survey Results; 37.2. Department Assessment Database for 2018-2019 Academic Year_BUS; 37.3 BUS Department Assessment Database-2017-2018 Academic Year; V.4.1. Annual_Report_2018-2019_academic_year_BUS_department ; Outcomes of the Academic Staff Satisfaction Survey]</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i venë në dispozicion dhe takimet e zhvilluara me titullarët, stafin akademik, NJSBC dhe studentët u konstatua se të gjithë aktorët janë përfshirë në proces në mënyrë të pavarur, kanë dhënë mendimet dhe kontributin e tyre përmes zbatimit të instrumentave të ndryshëm. GVJ konstatoi që është respektuar integriteti akademik i stafit gjatë gjithë procesit dhe nuk u identifikua ndonjë diskriminim apo pabarazi.</p> <p>[37. BA in BUS Course Instruction Survey Results; 37.2 Department Assessment Database for 2018-2019 Academic Year_BUS; 37.3 BUS Department Assessment Database-2017-2018 Academic Year; V.4.1. Annual_Report_2018-2019_academic_year_BUS_department ; Outcomes of the Academic Staff Satisfaction Survey; Annex 3.7.1 Hysa et al 2018 The Graduate Outcomes in the Labor Market_Ten Years of Achievements]</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e</p>	<p>Në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë përfshihet një anëtar/ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga Alumni. Duke ju referuar dokumentacionit, institucioni ka mundur të bëjë pjesë të proceseve të vlerësimit aktorë të jashtëm nëpërmjet përfshirjes në KPSC dhe zbatimit të instrumentave të ndryshme të vlerësimit.</p> <p>[http://aeqi.epoka.edu.al/cat-permanent-commission-on-</p>

mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	quality-assurance-1408.html			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UE ka të publikuara në faqen e internetit të gjitha dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë si: politikën e cilësisë, manualin për sigurimin e cilësisë, rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e KPSC, politikën për përmirësimin e vazhdueshëm të PS, rregulloren mbi funksionimin e bordit të provimeve. Gjithashtu në faqen që lidhet me NJSBC është publikuar përbërja e KPSC, bordit të provimeve, antarët e auditit të brendshëm, si dhe të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm (institucional dhe për çdo program studimi), dhe raportet vjetore të IAL. Ndërsa në faqen e departamentit janë të publikuara raportet vjetore të departamentit. GVJ konfirmon që IAL mundëson transparencë maksimale për të gjitha procedurat dhe proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. [http://aeqi.epoka.edu.al/home.html ; http://bus.epoka.edu.al/]
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Programi në fjalë është në akreditim periodik. Akreditimi i parë është bërë në vitin 2011 dhe akreditimi periodik në vitin 2017. RVB dhe RVJ janë të publikuara në faqen e IAL. Gjithashtu IAL bën publike për stafin dhe studentët rezultatet e pyetësoreve duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale. Aktorët e interesuar njihen me këto raporte përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të dokumentave. [http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html ; Outcomes of the Academic Staff Satisfaction Survey ; 37. BA in BUS Course Instruction Survey Results]
Kriteri 3. Rezultatet e	Departamenti ka hartuar një plan masash për të adresuar

<p>vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>rekomandimet e Bordit të Akreditimit në kuadër të vlerësimit të jashtëm. Plani i veprimit është miratuar nga Senati Akademik. Rekomandimet dhe statusi i plotësimit të tyre janë të publikura në faqen e internetit të IAL/NJSBC. Njësitë administrative dhe ato akademike përgatisin gjithashtu plane veprimi në përgjigje të gjetjeve të auditit të brendshëm të Universitetit.</p> <p>[https://drive.google.com/file/d/0Bw1_QkbaNe5IX3NDR3hRejU5NU0/view; Annex 6.16 -BUS Action Plan in Response to the Recommendations]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentet, Fakultetet dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel universiteti. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Raportet diskutohen në strukturat vendimarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre.</p> <p><i>GVJ mendon që krahas këtyre raporteve NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar.</i></p> <p>[Shënimet gjatë vizitës]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përfshirja e stafit në proceset e vlerësimit të brendshëm; 2. Informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit; 3. Përfshirja e studentëve në pilotimin e pyetësorëve. 4. Përfshirja e stafit akademik në vlerësimin e performancës; 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>
--	------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës VI	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Administrim Biznesi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Objektiva të qarta për PS Bch në Administrim Biznesi si dhe strategji e mirë adresuar për përmbushjen e tyre;
2. Përpuethshmëria me programe të ngjashme në universitete prestigjioze në Evropë;
3. Procedura rigoroze dhe transparente rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit;
4. Cilësia e lartë e mësimdhënies si rrjedhojë e kualifikimit të lartë të stafit dhe e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, që nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve;
5. Rritja e kapaciteteve të stafit akademik përmes trajnimeve, duke adresuar nevojat e tyre si dhe vlerësuar efektivitetin e tyre;
6. Marrëveshje bashkëpunimi efektive me universitete perëndimore dhe të vendeve të rajonit, si dhe me organizata publike dhe private në vend;
7. Fond i pasur i bibliotekës së institucionit, që zgjerohet vazhdimisht, nëpërmjet procedurave të blerjeve sipas kërkesave të stafit akademik të programit. Akses në bibliotekat online për personelin akademik dhe studentët;
8. Sistemi funksional i manaxhimit të nformacionit (EIS), me module të integruara dhe efektive, në shërbim të përdoruesve të ndryshëm, si stafi akademik, studentët, stafi administrativ dhe organet vendimmarrëse;
9. Mjedise të përshtatshme me kushte optimale dhe të pajisura me teknologjinë audio-vizive në shërbim të mësimdhënies;
10. Aplikimi i Bursave të meritës nxit regjistrimin e studentëve cilësorë si dhe rrit numrin e studentëve të regjistruar në program;
11. Sistem efektiv i sigurimit të cilësisë, me struktura dhe përgjegjësi të qarta, me përdorim të mekanizmave të diversifikuar, që i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë si dhe krijimit të kulturës së cilësisë në rang institucional;

b. Pika të dobta

1. Mungesa e praktikës profesionale ndikon negativisht në aftësimin praktik të studentëve;

2. Ngarkesa e lartë në mësimdhënie e stafit akademik, e shprehur në numër të lartë orësh mësimore që arrijnë deri në 640 orë;
3. Numëri i lartë i lëndëve për pedagog, nuk ndikon pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies, por sjellë dhe mungesë të balancës së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
4. Përfshirje e ulët e studentëve të programit në projekte dhe në kërkimin shkencor të njësisë bazë;


Rekomandime

1. GVJ rekomandon që institucioni të vlerësojë një shpërndarje më optimale të lëndëve, duke ulur numrin e lëndëve për pedagog, e cila krijon zbalancim mes ngarkesës mësimore dhe mundësisë për kërkim shkencor të stafit;
2. GVJ rekomandon që Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm të hartojë programe të trainimit të vazhduar dhe në fushën e administrim biznesit, çka do t'iu mundësonte studentëve që përfundojnë këtë PS të përditësojnë njohuritë e tyre dhe të marrin njohuri të reja;
3. GVJ rekomandon ulje të ngarkesës mësimore të shprehur në orë, për stafin akademik, pasi ndikon në motivimin e stafit si dhe në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
4. GVJ rekomandon një rritje të përfshirjes së studentëve të programit në projekte dhe në kërkimin shkencor dhe atë të aplikuar të institucionit;
5. GVJ rekomandon që NJSBC të hartojë një raport vjetor mbi aktivitetin e saj, instrumentat që përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Business Administration"

a. Strengths and affirmations:

1. Clear objectives for PS bch in Business Administration as well as a well-addressed strategy for their fulfilment;
2. Compatibility with similar programs at prestigious universities in Europe;
3. Rigorous and transparent recruitment and evaluation procedures, which guarantee the selection of staff with the required level of qualification;
4. High quality of teaching because of the high qualification of the staff and the use of modern teaching methods, which promote the active participation of students;
5. Increasing the capacities of the academic staff through trainings, addressing their needs and evaluating their effectiveness;




6. Effective cooperation agreements with western universities and countries in the region, as well as with public and private organizations in the country;
7. Enriched fund of the library of the institution, which is constantly expanding, through purchase procedures according to the requirements of the academic staff of the program. Access to online libraries for academic staff and students;
8. Functional information management system (EIS), with integrated and effective modules, at the service of various users, such as academic staff, students, administrative staff and decision-making bodies;
9. Suitable environments with optimal conditions and equipped with audio-visual technology in the service of teaching;
10. The application of Merit Scholarships promotes the enrolment of quality students and increases the number of students enrolled in the program;
11. An effective quality assurance system, with clear structures and responsibilities, with the use of diversified mechanisms, which serve the continuous improvement of quality as well as the creation of a quality culture at the institutional level;

b. Weaknesses:

1. Lack of professional practice negatively affects the practical preparation of students;
2. The high teaching load of the academic staff, expressed in a high number of teaching hours that reach up to 640 hours;
3. The high number of courses per lecturer does not positively affect the quality of teaching, but also leads to a lack of balance between teaching and research;
4. Low involvement of program students in projects and research of the basic unit;

Recommendations

1. EEG recommends that the institution should evaluate a more optimal distribution of courses, reducing the number of courses per lecturer, which creates an imbalance between teaching load and scientific research of staff;
2. EEG recommends that the Centre for Continuing Education should design continuing education programs in the field of business administration, which would enable students who complete this SP to update their knowledge and gain new knowledge;
3. EEG recommends reducing the teaching load expressed per hour, for the academic staff, as it affects the motivation of the staff as well as the quality of teaching and research;
4. EEG recommends an increase of the involvement of the program students in the projects and in the scientific and applied research of the institution;



5. EEG recommends that the IQAU should compile an annual report on its activities, the instruments used for internal evaluation and identify good practices and / or problems to be addressed;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Raimonda DUKA
Prof.Asoc.Dr Etleva LESKAJ

